



RAPORTI VJETOR 2021

DPAP

I.PËRMBAJTJA.....	1
II. KRIJIMI I DPAP-së	
II.1 Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e DPAP-së.....	3
II.2 Baza ligjore e funksionimit të DPAP-së	3
II.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e DPAP-së.....	3
II.4 Struktura DPAP-së dhe institucioneve të varësisë.....	4
III.TË DHËNA TË PËRGJITHSHME DHE VEPRIMTARI	4
III.1 Të dhëna për IAP për vitin shkollor 2020-2021, 2021-2022.....	5
III.2 Të dhëna mbi infrastrukturën e IAP-ve.....	6
III.3 Të dhëna mbi numrin e nxënësve në Arsimin Parauniversitar 2021-2022.....	8
III.4 Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar.....	10
III.5 Monitorim i ecurisë së procesit mësimor në kushtet e pandemisë Covid-19.....	12
III.6 Monitorimi i procedurave të punësimit të Oficerëve të Sigurisë në shkolla.....	13
III.7 Monitorim të detyrave të sektorit të shërbimeve në DRAP dhe ZVAP.....	14
III.8 Reforma e Drejtorëve, qëllimi i reformës.....	17
III.9 Testimi, punësimi nga portali “Mësues për Shqipërinë”.....	18
III.10 Studime dhe të dhëna parashikuese për vitin shkollor 2021-2022.....	24
III.11 DPAP-ja mbledh, përpunon dhe dërgon të dhëna sipas kërkesave.....	27
III.12 Informacione për VANAF, PKAB, Matura Shtetërore, sesioni i parë dhe i dytë.....	29
III.13 Trajtimi i gjetjeve të auditit të MAS dhe ndjekja në vijim e problematikave.....	30
IV.VEPRIMTARI DHE MONITORIME.....	30
IV.1 Shkolla qendër komunitare.....	30
IV.2 Praktika profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin 2021-2022.....	34
IV.3 Provimi i shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit- sesioni XVI-2021.....	39
IV.4 Kualifikimi i mësuesve 2021.....	40
IV.5 Pajisja e nxënësve me tekste falas dhe ato në përdorim falas për vitin 2021-2022.....	44
IV.6 Ecuria e nismës “Ditët e informimit të maturantëve 2021”.....	46
IV.7 Rrjetet profesionale.....	47
IV.8 Olimpiadat kombëtare.....	49
IV.9 Regjistrimi online i klasës I-rë dhe klasës X-të për vitin mësimor 2021-2022.....	50
IV.10 Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar- SMIP.....	51
IV.11 Nisma bëjmë detyrat e shtëpisë	52
IV.12 Gjuha angleze në klasën e parë.....	53
IV.13 Gjuha e huaj e parë dhe e dytë	54
IV.14 Vlerësimi i arritjeve VANAF.....	55
IV.15 Provimet kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2020-2021.....	57
IV.16 Matura Shtetërore 2021.....	66
IV.17 Programi kombëtar “Artet dhe zejet në shkollë”	68

IV.18 Shërbimi psiko-social shkollor 2021.....	69
IV.19 Identifikimi i nevojave të nxënësve për përmirësim.....	77
V. VEPRIMTARI MONITORUESE DHE VLERËSUESE PËR VITIN 2021.....	79
V.1 Të dhëna të përgjithshme mbi numrin e monitorimeve, vlerësimeve për vitin 2021.....	79
V.2 Të dhëna mbi shpërndarjen e monitorimeve/vlerësimeve sipas ZVAP-ve.....	81
V.3 Monitorimi i IAP për procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore për 2021-2022.....	83
V.3 Monitorimi i IAP-ve për zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe masat për MSH.....	84
V.5 Monitorimi dhe vlerësimi i IAP-ve për zbatimin e masave anti COVID – 19	85
V. 6 Veprimtari vlerësuese/inspektuese për vitin 2021.....	86
V.7. Vlerësimi/inspektimi i institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar publik.....	86
V.8 Vlerësimi/inspektimi i institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar privat.....	96
V.9.Vlerësimi/inspektimi i IAP-ve bazuar në ankime.....	102
V.10. Vlerësimi/inspektimi i zyrave vendore të arsimit parauniversitar.....	106
V.11 Vlerësimi/inspektimi i drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar.....	113
IV.12 Ankime.....	112
VI. ASPEKTE JURIDIKE	113
VII. ASPEKTE FINANCIARE, SHËRBIME, SHPENZIME.....	114
VIII. PERFORMANCA E PUNONJËSVE NË DPAP DHE INSTITUCIONET E	
VARËSISË.....	117
IX. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE.....	119
XI. KËSHILLIME.....	119
XII. KUALIFIKIM I BRENDSHËM, TRAJNIME	120

II. KRIJIMI I DPAP-së

II.1 Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e DPAP-së

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar është krijuar si institucion me **VKM, Nr. 99, datë 27.02.2019** “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

II.2 Baza ligjore e funksionimit të DPAP-së

DPAP-ja i ushtron funksionet e saj mbështetur në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrin Nr. 254, datë 30.04.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e DPAP”, Urdhrin Nr. 668, datë 05.04.2019, i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së DPAP dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrin Nr.234, datë 19.04.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Arsimore të Arsimit Parauniversitar”, si dhe urdhra dhe udhëzime të tjera të MASR-së në fushën e arsimit.

II.3 Misioni, detyrat dhe përgjegjësitë e DPAP-së

DPAP-ja është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor. DPAP-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet:

- **Në nivel qendror**, nëpërmjet drejtorisë qendrore - DPAP.
- **Në nivel rajonal**, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar - DRAP.
- Në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë **zyrat vendore të arsimit parauniversitar - ZVAP**.
- **Në institucionet arsimore** të sistemit parauniversitar publik, shkollat.

❖ Misioni i DPAP-së

Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

❖ Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, DPAP-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka **përgjegjësi** për:

- Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- Organizimin e punës për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik sipas legjislacionit në fuqi.
- Sigurimin se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike të arsimit parauniversitar, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të licensimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, *si dhe t'i propozojë ministrit dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë.*
- Vlerësimin, nëpërmjet DRAP-ve dhe ZVAP-ve, të kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe të shqyrtojë përmbushjen e kriterëve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore e ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.


❖ Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, DPAP-së


Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar:

- Bashkërendon zbatimin e politikave, strategjive të zhvillimit, programeve, projekteve, kuadrin rregullator dhe kurrikulën në fushën e arsimit parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- Siguron, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore arsimore, inspektimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe të sistemit arsimor parauniversitar.
- Analizon dhe përcakton kostot e realizmit të shërbimeve arsimore, duke përmbledhur e përpunuar të dhëna nga drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe institucionet arsimore.
- Mbështet institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar (ASCAP) për zbatimin e dokumenteve kurrikulare, për zhvillimin profesional, për organizimin e kualifikimit të punonjësve arsimorë dhe për mbledhjen e të dhënave statistikore në sistemin e arsimit parauniversitar.
- Në përputhje me analizat e kryera, planifikon organizimin dhe shtrirjen e shërbimit arsimor, programon punën, siguron dhe optimizon burimet për ofrimin e shërbimeve arsimore parauniversitare, si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm për institucionet publike të arsimit të parauniversitar.
- Siguron mbledhjen, plotësimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore për institucionet arsimore, sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

- Mbështet ministrinë dhe institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar me të dhëna, ekspertizë teknike dhe propozime në hartimin e politikave të zhvillimit në fushën e arsimit parauniversitar, duke marrë parasysh veçoritë demografike, të terrenit, të zhvillimit ekonomik e të infrastrukturës vendore.
- Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar procesin e përzgjedhjes, si dhe shpërndarjen dhe pajisjen e institucioneve arsimore me tekste shkollore dhe raporton në MASR për monitorimin e kryer.
- Siguron koordinimin e veprimtarive të drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
- Koordinon administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- Drejton dhe mbikëqyr procedurat e punësimit të mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”.

II.4 Struktura e DPAP-së dhe e institucioneve të varësisë





Numri i punonjësve të administratës në DPAP, 4 DRAP-et dhe 52 ZVAP-të në varësi.

Nr	DREJTORIA	STRUKTURA URDHËR 47 DATË 18.03.2021	DREJTOR	Sekretare	Koordinator Antikorrupsioni	Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional	Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës	Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë
I	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar	21	1	1	1	6	5	7
I.	DRAP-Durrës	15	1	1	1	4	4	4
1	ZVAP Bulqizë	6	1			3	2	
2	ZVAP Mat	6	1			3	2	
3	ZVAP Klos	6	1			3	2	
4	ZVAP Shijak	6	1			3	2	
5	ZVAP Kavajë	8	1			4	3	
6	ZVAP Vorë	6	1			3	2	
7	ZVAP Rrogozhinë	6	1			3	2	
8	ZVAP Dibër	9	1			5	3	
9	ZVAP Krujë	8	1			4	3	
10	ZVAP Kamëz	11	1			6	4	
11	ZVAP Durrës	15	1			10	4	
12	ZVAP Tiranë	35	1			23	11	
II.	DRAP- Fier	15	1	1	1	4	4	4
13	ZVAP Patos	6	1			3	2	
14	ZVAP Roskovec	6	1			3	2	
15	ZVAP Divjakë	6	1			3	2	
16	ZVAP Mallakastër	6	1			3	2	
17	ZVAP Selenicë	6	1			3	2	
18	ZVAP Finiq-Dropull	6	1			3	2	
19	ZVAP Girokastër-Libohovë	6	1			3	2	
20	ZVAP Tepelenë- Memaliaj	6	1			3	2	
21	ZVAP Përmet-Këlcyrë	6	1			3	2	
22	ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë	9	1			5	3	
23	ZVAP Lushnjë	11	1			6	4	
24	ZVAP Vlore-Himarë	11	1			6	4	

25	ZVAP Fier	15	1			10	4	
III.	DRAP-Korçë	15	1	1	1	4	4	4
26	ZVAP Ura Vajgujore	6	1			3	2	
27	ZVAP Kuçovë	6	1			3	2	
28	ZVAP Cërrik	6	1			3	2	
29	ZVAP Belsh	6	1			3	2	
30	ZVAP Peqin	6	1			3	2	
31	ZVAP Gramsh	6	1			3	2	
32	ZVAP Librazhd	9	1			5	3	
33	ZVAP Përenjas	6	1			3	2	
34	ZVAP Maliq	8	1			4	3	
35	ZVAP Kolonjë	6	1			3	2	
36	ZVAP Devoll	6	1			3	2	
37	ZVAP Skrapar	6	1			3	2	
38	ZVAP Poliçan	6	1			3	2	
39	ZVAP Berat	10	1			6	3	
40	ZVAP Korçë-Pustec	9	1			5	3	
41	ZVAP Pogradec	9	1			5	3	
42	ZVAP Elbasan	15	1			10	4	
IV.	DRAP- Lezhë	15	1	1	1	4	4	4
43	ZVAP Has	6	1			3	2	
44	ZVAP Tropojë	6	1			3	2	
45	ZVAP Mirditë	6	1			3	2	
46	ZVAP Malësi e Madhe	6	1			3	2	
47	ZVAP Vau Dejës	6	1			3	2	
48	ZVAP Puke -Fushë Arrëz	6	1			3	2	
49	ZVAP Kukës	10	1			6	3	
50	ZVAP Lezhë	10	1			6	3	
51	ZVAP Kurbin	9	1			5	3	
52	ZVAP Shkodër	15	1			10	4	
	TOTALI	509	57	5	5	259	160	23

III. TË DHËNA DHE VEPRIMTARI

III.1 Të dhëna mbi numrin e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022


Në vitin shkollor 2020-2021 në arsimin publik rezultojnë 199 shkolla të mesme të bashkuara dhe 934 shkolla vartëse. Numri i institucioneve arsimore paraqitet më poshtë:

Kopshte gjithsej		Kopshte	Shkolla publike (drejtori më vete)		Shkolla publike	Shkolla private (drejtori më vete)		Shkolla private
Publike	Private		9-vjeçare + SHMB	Gjimnaze+ të mesme të bashkuara		9-vjeçare	Të mesme	
1907	249	2156	1057	346	1403	115	105	220

Në vitin shkollor 2021-2022 në krahasim me vitin shkollor 2020-2021 kemi një rënie të numrit të institucioneve arsimore, kopshte publike dhe private janë 66 më pak, kemi 5 shkolla publike me drejtori më pak, ndërkohë që numri i shkollave private ka mbetur i pandryshuar. Në arsimin publik janë 197 shkolla të mesme të bashkuara dhe 874 shkolla vartëse.

Të dhënat për numrin e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2021-2022 paraqiten në tabelën si më poshtë:

Kopshte gjithsej		Kopshte	Shkolla publike (drejtori më vete)		Shkolla publike	Shkolla Private (drejtori më vete)		Shkolla private
Publike	Private		9-vjeçare + SHMB	Gjimnaze+ të mesme të bashkuara		9-vjeçare	Të mesme	
1847	243	2090	1051	347	1398	115	105	220



Gjatë vitit shkollor 2021-2022, për shkak të rënies së numrit të nxënësve, ka kopshte dhe shkolla vartëse të mbyllura si edhe shkolla qendër që kanë kaluar në shkolla vartëse.

III.2 Të dhëna mbi infrastrukturën e IAP-ve


Për vitin 2021 janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme IAP-të mbi gjendjen infrastrukturore të tyre. Në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore u bë e mundur, që shumica e IAP-ve të ishin gati në shtator 2021, për fillimin e procesit mësimor dhe u morën masat për të siguruar ngrohjen. Aktualisht në gjithë territorin rezultojnë 36 shkolla me problematika të theksuara sa i takon ngrohjes. Në 17 objekte shkollore, të cilat nuk krijojnë kushtet për fillimin e procesit mësimor, u trajtuan duke siguruar mjedise me qera për të vijuar procesin mësimor. Nga godinat shkollore në proces rindërtimi, 59 prej tyre do të kompletohen brenda vitit 2022.

- **Gjendja infrastrukturore e IAP-ve, si më poshtë vijon:**

Nga raportimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar numri i shkollave me mjedise laboratorike është i vogël kundrejt totalit të godinave. Vetëm rreth 20% e shkollave të arsimit bazë me drejtori më vete dhe arsimit të mesëm të lartë zotërojnë mjedise laboratorike të shkencave ekzakte. Këto shkolla janë kryesisht të vendosura në zonat urbane. Në sistemin e arsimit parauniversitar kemi kryesisht klasa laborator pasi dhe pajisjet laboratorike të furnizuar në 20 vjeçarin e fundit janë për laboratorë demonstrative, përdoren vetëm nga mësuesi për demonstrimin e eksperimenteve sipas programit lëndor. Për shkollat e reja në ndërtim e sipër, bazuar në standardet e arsimit parauniversitar janë parashikuar mjedise për laboratorë dhe në objekte me mbi 16 klasa, këto laboratorë janë parashikuar të dedikuar për lëndët kimi, fizikë, biologji dhe informatikë.

- Laboratorët TIK dhe ngrohja në IAP-të:

Në IAP publik, 674 shkolla kanë laboratorë TIK. 307 IAP publike janë me sistem ngrohje qendror



dhe shumica e IAP-ve përdorin ngrohje alternative, si: soba me dru zjarri, soba me pelet, ngrohëse elektrike dhe kondicioner. 36 IAP raportojnë për probleme në lidhje me amortizimin e sistemit elektrik dhe mungesën e furnizimit për realizimn e ngrohjes alternative.

- Gjendja e terreneve sportive:

330 shkolla kanë palestër dhe terren sportiv, 695 kanë vetëm terrene sportive dhe 159 kanë vetem palestra, ndërkohë 8 shkolla nuk kanë terrene sportive të dedikuara.

- Gjendja e mjediseve të bibliotekave në sistemin e arsimit parauniversitar:

Rreth 80 % e shkollave kanë mjedise për bibliotekë, bazuar në raportimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar. Bibliotekat në shkolla janë të krijuara kryesisht në klasa mësimore dhe më pak në mjedise të veçanta. Gjatë vitit 2021 nga 4 DRAP janë zhvilluar procedura prokurimi dhe janë furnizuar shkolla me libra artistikë për një vlerë totale prej rreth 16 milion lekë nga 20 milion në dispozicion.

Përtej furnizimit me biblioteka fizike, duhet parë mundësia e shfrytëzimit të bibliotekës digjitale nga nxënësit. Një pjesë e titujve artistik janë të digjitalizuara nga biblioteka kombëtare. Duhet gjetur mundësitë që këto libra të përdoren dhe nga nxënësit e shkollave, sidomos të atyre të shkollave të mesme. Kjo do të krijojë mundësinë në shkolla të krijimit të mjedisit për përdorimin e bibliotekës digjitale dhe mbështetje për këtë qëllim mund të jenë kabinetet e informatikës.


- Fondet për bibliotekat e institucioneve arsimore:

Fondet për bibliotekat e institucioneve arsimore				
Nr	DRAP	Përshkrimi	Plan	Realizuar
1	Durrës	Krijim fond bibliotekash për shkollat	8,900,000	5,044,909
2	Fier	Krijim fond bibliotekash për shkollat	3,500,000	3,341,913
3	Korçë	Krijim fond bibliotekash për shkollat	4,500,000	4,364,374
4	Lezhë	Krijim fond bibliotekash për shkollat	3,100,000	3,063,372
	Totali	Krijim fond bibliotekash për shkollat	20,000,000	15,814,568

III.3 Të dhëna mbi numrin e nxënësve në Arsimin Parauniversitar 2021-2022



Numri i nxënësve sipas tre niveleve të arsimit parauniversitar: parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm e lartë vijon si më poshtë:

Nxënës në Arsimin Parauniversitar 2021-2022			
Nxënës	Total	Publik	Privat
Gjithsej	435.710	386.353	49.357
Arsimi Parashkollor	72.384	62.104	10.280
Arsimi Bazë	278.138	251.207	26.931
Arsimi i Mesëm i Lartë	85.188	73.042	12.146
Gjimnaz	82.367	70.221	12.146
Gjimnaz me kohë të plotë	77.452	65.306	12.146
Gjimnaz me kohë të pjesshme	4.915	4.915	0
Shkolla të mesme të orientuara	2.821	2.821	0
Gjimnaze të orientuara (me kohë të plotë)	2.821	2.821	0
Nxënës në Maturë	27.879	23.859	4.020




Nxënës Rom në sistemin arsimor parauniversitar	Total	Publik	Privat	Nxënës Egjiptian në sistemin arsimor parauniversitar për vitin mësimor 2021-2022	Total	Publik	Privat
Gjithsej	4.338	4.274	64	Gjithsej	9.997	9.846	151
Arsim parashkollor	690	674	16	Arsim parashkollor	1.694	1.664	30
Arsimi Bazë	3.475	3.438	37	Arsimi Bazë	7.458	7.350	108
Arsimi fillor	2.357	2.334	23	Arsimi fillor	4.266	4.203	63
Arsimi i mesëm i ulët	1.118	1.104	14	Arsimi i mesëm i ulët	3.192	3.147	45
AML dhe Shkolla të orientuara	173	162	11	AML dhe Shkolla të orientuara	845	832	13

AML me kohë të plotë	129	118	11	AML me kohë të plotë	612	599	13
AML me kohë të shkurtuar	36	36	0	AML me kohë të shkurtuar	141	141	0
AM i orientuar	8	8	0	AM i orientuar	92	92	0



Nxënës të kthyer nga emigracioni për vitin 2021-2022	Total	Publik	Privat
Gjithsej	672	585	87
Arsim parashkollor	0		
Arsimi Bazë	599	528	71
Arsimi fillor	320	277	43
Arsimi i mesëm i ulët	279	251	28
AML dhe shkolla të orientuara	73	57	16
AML me kohë të plotë	59	43	16
AML me kohë të shkurtuar	9	9	0
AML i orientuar	5	5	0



- Nxënës nga minoritetet për vitin 2021-2022:

Në sistemin parauniversitar janë të regjistruar në arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë 545 nxënës në 18 shkolla publike dhe private të shpërndara në ZVAP Korçë-Pustec, Finiq-Dropull, Sarandë-Delvinë-Konispol dhe Gjirokastrë-Libohovë.

- Raporti nxënës-mësues në sistemin arsimor parauniversitar për vitin 2021-2022:

Niveli arsimor	Publik			Privat			Total		
	Nxënës	Mësues	Raporti	Nxënës	Mësues	Raporti	Nxënës	Mësues	Raporti
Arsim parashkollor	62104	4398	14,1	10280	954	10,8	72384	5352	13,5

Arsimi Bazë (pa klasat kolektive dhe mësues në klasa kolektive)	219085	19265	11,4	26931	2577	10,5	246016	21842	11,3
Arsimi i Mesëm	73042	5735	12,7	12146	1533	7,9	85188	7268	11,7
Totali	354231	29398	12,0	49357	5064	9,7	403588	34462	11,7




III.4 Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar


- Numri i punonjësve mësimor shtator 2021 vetëm në arsimin parauniversitar publik pa përfshirë arsimin parashkollor dhe atë privat.

INSTITUCIONI	Punonjës mësimor AMU 2021-2022	Punonjës mësimor AML 2021-2022
DRAP FIER	4,692	1,281
Zyra Vendore Arsimore, Fier	963	228
Zyra Vendore Arsimore, Patos	169	44
Zyra Vendore Arsimore, Roskovec	200	43
Zyra Vendore Arsimore, Lushnje	690	202
Zyra Vendore Arsimore, Divjakë	320	100
Zyra Vendore Arsimore, Mallakatër	265	48
Zyra Vendore Arsimore, Gjirokastrë-Libohovë	266	124
Zyra Vendore Arsimore, Tepelene-Memaliaj	261	58
Zyra Vendore Arsimore, Permet-Këlcyrë	172	51
Zyra Vendore Arsimore, Vlorë-Himare	830	240
Zyra Vendore Arsimore, Selenicë	157	55
Zyra Vendore Arsimore, Sarandë-Delvinë-Konispol	321	70
Zyra Vendore Arsimore, Finiq-Dropull	78	18
DRAP KORÇË	6,113	1,605
Zyra Vendore Arsimore, Berat	499	171
Zyra Vendore Arsimore, Ura Vajgurore	292	69
Zyra Vendore Arsimore, Kuçovë	257	75
Zyra Vendore Arsimore, Skrapar	150	32
Zyra Vendore Arsimore, Poliçan	107	23
Zyra Vendore Arsimore, Elbasan	1,262	338
Zyra Vendore Arsimore, Cërrik	263	59
Zyra Vendore Arsimore, Belsh	170	35
Zyra Vendore Arsimore, Peqin	240	50
Zyra Vendore Arsimore, Gramsh	347	83
Zyra Vendore Arsimore, Librazhd	382	88
Zyra Vendore Arsimore, Prenjas	267	80
Zyra Vendore Arsimore, Korçë-Pustec	573	174
Zyra Vendore Arsimore, Maliq	387	89
Zyra Vendore Arsimore, Kolonjë	110	29
Zyra Vendore Arsimore, Devoll	220	55
Zyra Vendore Arsimore, Pogradec	587	155

DRAP DURRËS	8,754	2,491
Zyra Vendore Arsimore, Dibër	676	135
Zyra Vendore Arsimore, Bulqizë	326	69
Zyra Vendore Arsimore, Mat	276	81
Zyra Vendore Arsimore, Klos	189	48
Zyra Vendore Arsimore, Durrës	1,267	332
Zyra Vendore Arsimore, Shijak	198	32
Zyra Vendore Arsimore, Krujë	527	114
Zyra Vendore Arsimore, Tiranë	3,658	1,302
Zyra Vendore Arsimore, Kamëz	779	204
Zyra Vendore Arsimore, Vorë	251	64
Zyra Vendore Arsimore, Kavajë	367	75
Zyra Vendore Arsimore, Rrogozhinë	240	35
DRAP LEZHË	4,096	1,108
Zyra Vendore Arsimore, Kukes	589	149
Zyra Vendore Arsimore, Has	187	51
Zyra Vendore Arsimore, Tropojë	266	71
Zyra Vendore Arsimore, Lezhë	541	178
Zyra Vendore Arsimore, Mirditë	209	73
Zyra Vendore Arsimore, Kurbin	416	118
Zyra Vendore Arsimore, Malsi e Madhe	317	75
Zyra Vendore Arsimore, Shkodër	1,065	299
Zyra Vendore Arsimore, Vau i Dejës	261	49
Zyra Vendore Arsimore, Pukë- Fushë Arrës	245	45
TOTALI	23,655	6,485




Numri të punonjësve privat dhe publikë sipas programeve dhe sipas niveleve arsimore të miratuara nga Ministria e Arsimit	TOTAL	Publik	Privat
Gjithsej	37.021	31.956	5.065
Kopshte	5.352	4.398	954
Arsimi Bazë	24.400	21.823	2.577
Arsimi fillor	9.668	8.564	1.104
Arsimi i mesëm i ulët	14.732	13.259	1.473
AML +Gjimnaze te orientuara	7.269	5.735	1.534
Gjimnaz	6.718	5.184	1.534
Gjimnaze te orientuara	551	551	0



III.5 Monitorim i ecures së procesit mësimor në kushtet e pandemisë Covid -19


Gjatë vitit shkollor 2020-2021 në institucionet e arsimit parauniversitar procesi mësimor ka vijuar normalisht, sipas skenarëve të miratuar dhe turneve përkatëse, sipas udhëzimit të fillimit të vitit shkollor dhe në zbatim të Udhëzimit të MSHMS, mbi kujdesin dhe masat anti Covid-19, në strukturat arsimore parauniversitare.

DPAP ka monitoruar me shumë kujdes ecurinë e procesit mësimor, duke patur në qendër të vëmendjes shëndetin e nxënësve dhe të personelit mësimor, nëpërmjet informacioneve të përditëshme të marra nga 52 ZVAP-të, për problematika të konstatuara, për numrin e nxënësve dhe mësuesve që kanë munguar, si të konfirmuar me Covid-19 apo të karantinuara. Duke bërë mesatarizimin për çdo muaj të dhënave për nxënës dhe mësues të konfirmuar me Covid-19, për periudhën Shtator 2020 – Maj 2021, situata paraqitet si më poshtë:



Duke filluar nga muaji dhjetor 2020, në përgjigje të situatës së krijuar nga Covid-19 dhe në zbatim të shtojcës 1 “Mbi disa plotësime në udhëzuesin e fillim vitit shkollor 2020-2021”. Institucionet arsimore e vijuan procesin mësimor në zbatim të udhëzimit, sipas skenareve 1, 2 dhe 3, sipas kushteve të çdo institucioni. Skenarët që ndiqnin institucionet arsimore ishin të ndryshëm për javë të ndryshme në varësi të kushteve. Më poshtë po paraqesim skenarët e ndjekur nga shkollat në dy periudha: Dhjetor 2020, Mars 2021.

Nr.		SKENARËT				
		1	2.1	2.2	2.3	3
1	Dhjetor 2020	79%	7%	9%	6%	
2	Mars 2021	74%	5%	7%	4%	10%



Theksojmë se nga 15 shkurt 2021, 10 % e shkollave zbatuan skenarin 3, pas vendimit të Komitetit të Eksperteve, ku 10 bashki u kategorizuan si zona me risk të lartë. Institucionet e arsimit të mesëm të lartë të këtyre bashkive e realizonin mësimin online, pra me skenarin 3 dhe procesin mësimor e realizuan nëpërmjet platformave të ndryshme digjitale.


Viti shkollor 2021-2022 nisi në të gjitha institucionet arsimore me skenarin 1, në ambientet e shkollave në kushte normale, por duke zbatuar të gjitha masat anti Covid-19 dhe ku rreth 95 % e mësuesve ishin të vaksinuar.

III.6 Monitorimi i procedurave të punësimit të Oficerëve të Sigurisë në shkolla

Në bazë të Vendimit Nr.600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, në institucionet arsimore publike ofrojnë shërbimin 150 oficer sigurie.

Shpërndarja e Oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore, në nivel DRAP është si më poshtë:

Nr.	DRAP	Numri i OS
1	Durrës	61
2	Fier	23
3	Korçë	42
4	Lezhë	24
	Totali	150



Në zbatim të shkresës së MASR Nr.1595 prot, datë 17.03.2021 “Për procedurat e emërimit të oficerëve të sigurisë”, pika 3, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, ka vijuar procedurat për plotësimin e vendeve vakante të pa plotësuar pas kryerjes së procedurave nga Drejtoritë Rajonale, duke njoftuar kandidatët e certifikuar, por të papunësuar në të gjitha ZVAP-të (ish DAR/ZA), sipas listës dhe renditjes, të dërguar nga MASR.

- Në Muajin Prill 2021 janë hapur procedurat për 7 vende vakante, ku nga 26 oficerë sigurie u paraqitën vetëm 2 kandidatë, dhe vetëm njëri prej tyre pranoi pozicionin e ofruar. Mbetën vakante 6 pozicione.
- Në muajin shtator 2021 u zhvilluan procedurat për 9 vende vakante, ku nga 22 oficerë sigurie të pa punësuar, u paraqitën vetëm 3 kandidatë, mbetën vakante 6 pozicione.
- Në janar 2022, për plotësimin e vendeve vakante të oficerit të sigurisë, nuk ka pasur kandidatë të certifikuar që të pranojnë pozicionet e ofruara dhe këto pozicione vazhdojnë të jenë vakante, si më poshtë:

NR.	Qarku	ZVAP	Gjimnazi	Vakant/ Provizor
1	Dibër	Dibër	Kastriot	vakant
2	Tiranë	Tiranë	“A.Z. Çajupi”	provizor l.lindje
3	Vlorë	Vlorë	“Halim Xhelo”	provizor l.lindje
4	Berat	Urë vajguore	Kutalli	vakant
5	Shkoder	Pukë	Fushë-Arrëz	vakant
6	Kukës	Tropojë	Asim Vokshi	vakant

III.7 Monitorim të detyrave të sektorit të shërbimeve në DRAP dhe ZVAP

Gjatë muajit Prill-Maj 2021, në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.60, datë 14.04.2021 “Për verifikimin e regjistrat themeltar të punonjësve në 4 DRAP dhe 52 ZVAP, librin e pagave, dosjet e personelit të punësuar në DRAP dhe ZVAP”, u krye verifikimi i dosjeve personale të punonjësve të DRAP dhe ZVAP.

Gjetje dhe Rekomandime:

- Në disa ZVAP ende nuk ishin hapur regjistrat themeltar për punonjësit e ZVAP dhe për punonjësit mësimor.

Rekomandim: Punonjësi i ngarkuar me burimet njerëzore, duhet të bëjë hapjen dhe plotësimin e të gjithë elementeve të regjistrat themeltar, duhet të hedh të dhënat mbi historikun e punës së punonjësit duke u bazuar në librezën e punës.

Për ZVAP e reja të krijuara sipas Urdhër Nr.234, datë 19.04.2019 të MASR “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”, Urdhrit të Ministrit të MASR nr. 47, datë 18.03.2021- “ Për disa ndryshime të urdhrit nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, i ndryshuar të bëhet transferimi dhe pasqyrimi në regjistra themeltar të mësuesve të transferuar në ZVAP-ët përkatëse.

- Në disa dosje u konstatua mungesa të dokumentacionit.

Rekomandim: Punonjësit e ngarkuar me administrimin e dosjeve të personelit të plotësojnë në mënyrë të saktë dhe të plotë dosjet e personelit, me të gjitha elementët që duhet të jenë në dosje.

- Në disa ZVAP për mbylljen e pagave të punonjësve të personelit nuk operohet me sistemin HRMIS.

Rekomandim: Punonjësit e ngarkuar me burimet njerëzore dhe financën duhet të bëjnë rakordimin ndërmjet tyre, për gjenerimin e kredencialeve të sistemit HRMIS për institucionin e tyre.

- Në disa raste librat e pagave të punonjësve të personelit mbahen vetëm në mënyrë elektronike, ose nuk ekzistojnë fare, pasi si libër pagash përdoren listëpagesat e punonjësve.

Rekomandim: Punonjësi i ngarkuar me financën, duhet të hedhë të dhënat mbi historikun e pagave të punonjësit të ZVAP- së në një regjistër të veçantë, sipas formatit të caktuar, duke u bazuar në pagat e marra nga punonjësi çdo muaj.

- **Monitorime të proceseve të punës në DRAP dhe ZVAP sa i takon zbatimit të buxhetit për sigurimin e shërbimit të transportit:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka vlerësuar gjatë vitit 2021:

- procedurat e ndjekura nga Drejtoritë Rajonale e Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Paraunive për parashikimin e shpenzimeve të transportit të mësuesve dhe nxënësve dhe realizimin e procedurave të prokurimit për këtë shërbim për vitin 2020 dhe 2021”,
- procedurat e ndjekura në lidhje me parashikimin e shpenzimeve të transportit të mësuesve dhe nxënësve për realizimin e prokurimit për këtë shërbim gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Në dy nga drejtoritë rajonale ky proces është kryer duke rezultuar i pasuksesshëm, në DRAP Korçë e cila ka autorizuar zyrat arsimore të vijnë më tej me likuidimin e shpenzimeve të transportit në llogaritë e mësuesve dhe të prindërve të nxënësve që përfitojnë sipas VKM-së përkatëse. Dhe DRAP Lezhë e cila ka lidhur kontratat përkatëse. Ndërkohë në drejtoritë Rajonale Fier, Durrës dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi të tyre këto procedura nuk janë kryer.

Monitorimi është mbështetur, në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit 10296 datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Vendimit nr.682 datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 5544 Prot. datë 8.09.2020 “Mbi shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2021” si dhe të regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik 2021 për DRAP Fier, DRAP Durrës dhe ZVAP-et në varësi.

Nga analiza e kryer për etapat e ndjekura në lidhje me zbatimin e bazës ligjore në fuqi, rezultojnë: Në bazë ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij është përcaktuar në nenin 11, procedura e blerjes së përqëndruar:

Prokurimi i përqëndruar dhe organi qëndror blerës.

1. Në përputhje me nenin 11 të LPP dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave mund t'ia ngarkojë rolin e organit qëndror blerës një autoriteti tjetër kontraktor për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve të njëjta, në emër dhe përlllogari të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qëndror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij.

2. Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për të prokuruar në emër të tyre

Në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 2, përcaktohej gjithashtu se:

Mbi bazën e fondeve të miratuar çdo ZVAP ka hartuar regjistrin e parashikimit të prokurimeve paraqitur më sipër dhe nëse kishte parashikuar nevojën e shërbimit **duhet ti drejtohej DRAP me një kërkesë zyrtare për nisjen e procesit të prokurimit.**

Në këtë proces përtej rolit shumë të rëndësishëm që duhet të kishin drejtuesit e institucioneve apo nëpunësit zbatues të tyre, jo më pak i rëndësishëm ka qenë roli i personave përgjegjës për prokurimin. Citojmë më poshtë përcaktimet e **Nenit 57, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.**

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit:

1. Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t'u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë. Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore.

3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

-Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrimit të parashikimit dhe regjistrimit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

-Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

-Hartimin e urdhrave të prokurimit;

-Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

-Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

Në rast se detyrat e sipërpërmendura nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësi e prokurimit për objektin që prokurohet.¹

Nga informacioni i vendosur në dispozicion nga të gjitha ZVAP-të si dhe nga DRAP-et rezulton se në lidhje me shpenzimet e transportit për mësuesit dhe nxënësit, konstatohet se DRAP Fier dhe DRAP Durrës nuk kanë realizuar procedurat e prokurimit për këtë shërbim dhe zyrtarë arsimorë kanë vepruar duke kryer likuidimin e shpenzimeve për mbulimin e këtij shërbimi pa kryer procedurat përkatëse.

III.8 Reforma e Drejtorëve, qëllimi i reformës:

- Ndryshim cilësor në drejtimin e shkollës
- Rritja e performancës së drejtuesve
- Përfshirja në drejtim e aspirantëve të certifikuar tashmë nga shkolla e drejtorëve

Analiza e gjendjes

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.7961 dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Udhëzimit të MASR me Nr.2 dt 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, Udhëzimit me Nr.57 datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrtarë Vendore të Arsimit Parauniversitar kanë marrë masat e duhura ligjore, referuar udhëzimeve më lart që të gjithë drejtorët dhe nëndrejtorët e IAP-ve në sistem, të plotësojnë kushtet e kërkuara mbi arsimin dhe kualifikimin dhe të kenë performancën e duhur në drejtimin e shkollës:

Në shkollat publike 53% e drejtuesve janë femra ndërkohë që në arsimin privat përfaqësimi i femrave në drejtim është në masën 73%.

Të certifikuar nga shkolla e drejtorëve që aktualisht punojnë në sistem janë 68 drejtor dhe 44 nëndrejtor për arsimin publik, 4 drejtor dhe 2 nëndrejtor për shkollat private. Gjithsej të certifikuar nga shkolla e drejtorëve deri në këtë moment janë 230 kandidatë. Në shifrat më sipër nuk janë

¹ Ky nen është ndryshuar me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

paraqitur të dhëna për drejtimin e institucioneve të arsimit parashkollor. Nga inspektimet e kryera apo trajtimin e ankesave në bashkëqeverisje qartazi kemi identifikuar drejtues të cilët duhen zëvendësuar.

Menjëherë pas daljes së udhëzimit të ri në gjithë territorin do të zhvillohen konkurset për drejtor dhe nëndrejtor në vendet vakante, të komanduar apo që janë konstatuar me performancë të dobët dhe në këto konkurse synojmë të kryejmë ndryshime pozitive duke afruar drejtues të përkushtuar të cilët do të ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e IAP-ve.

Me përfundimin e procesit të certifikimit edhe të kohortës së tretë të kandidatëve që po ndjekin kursin pranë Shkollës së Drejtorëve apo me njehsimin e certifikatës së përfutur nga një grup i madh mësuesish (rreth 260) të cilët kanë kryer kursin e IZHA në vitin 2016, sistemi do të ketë më shumë konkurrentë për vendet që do të publikohen për konkurim

- Të dhëna të përmbledhura për arsimin publik dhe privat.

DRAP	DREJTOR GJITHSEJ PUBLIK	DREJTOR FEMRA PUBLIK	ZVDREJTOR GJITHSEJ PUBLIK	ZVDREJTOR FEMRA PUBLIK	DREJTOR GJITHSEJ JOPUBLIK	DREJTOR FEMRA JOPUBLIK	ZVDREJTOR GJITHSEJ JOPUBLIK	ZVDREJTOR FEMRA JOPUBLIK
Durrës	375	201	345	255	78	54	65	45
Fier	257	160	117	92	33	16	9	6
Korçë	332	175	170	124	17	12	9	5
Lezhë	219	113	104	69	25	18	17	13
GJITHSEJ	1183	649	736	540	153	100	100	69

- Procesi i certifikimit nga shkolla e drejtorëve:

- Në 2019 u pilotua nga CSL certifikimi i grupit të parë të drejtuesve të shkollës
- Deri në dhjetor 2021 nga Shkolla e Drejtorëve janë certifikuar 230 drejtues
- Në këtë numër janë 100 drejtues, 73 nëndrejtor dhe 57 aspirant
- Është në përfundim trajnimi i brezit të tretë dhe përgatitja për fillimin e kursit për brezin e katërt
- Në proces ekuivalentimi janë rreth 260 aplikantëve që ka ndjekur kursin e IZHA për drejtimin e shkollës në vitin 2016


DRAP	DREJTOR CERTIFIKUAR PUBLIK	DREJTOR CERTIFIKUAR JOPUBLIK	ZVDREJTOR CERTIFIKUAR PUBLIK	ZVDREJTOR CERTIFIKUAR JOPUBLIK	NDJEKIN KURSIN CSL GJITHSEJ	PRANUAR NGA CSL GJITHSEJ	APLIKUAR PER TU PRANUAR NGA CSL GJITHSEJ
GJ	68	4	44	2	220	276	331

III.9 Testimi, punësimi nga portali “Mësues për Shqipërinë” në vite

- **Punësime nga portali “Mësues për Shqipërinë” për periudhën Janar-Dhjetor 2021**
DPAP, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.99 informohet çdo muaj, nga Drejtoritë Rajonale mbi punësimet e kryera në institucionet arsimore të varësisë. Bazuar në Udhëzimin Nr.12 datë 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, Udhëzimin Nr.14 datë 28.07.2021 për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, ZVAP monitorojnë dhe dërgojnë informacion mbi punësimet nga portali “Mësues për Shqipërinë” me kontratë të përkohëshme, me kontratë të përherëshme, si edhe punësimet jashtë portalit.

Referuar këtyre raportimeve, situata paraqitet si më poshtë:

DRAP	Punësime vende vakante definitive nga portali	Punësime vende vakante provizore nga portali	Gjithsej punësime
DRAP Durrës	496	1005	1501
DRAP Fier	120	749	869
DRAP Korçë	168	781	949
DRAP Lezhë	126	374	500
Totali Janar – Dhjetor 2021	910	2909	3819



- Testimi për portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021:

DRAP	Pjesëmarrës në testimin e informatizuar në QShA
Durrës	2540
Fier	1220
Korçë	1834
Lezhë	727
Gjithsej	6321

Profili	Të regjistruar	Pjesëmarrja	Pikë mesatare
Arsimi Fillor	979	917	56.11
Arsimi Parashkollor	749	674	47.95
Arsimi Special	50	49	59.65
Art Pamor	8	5	52.8
Art Pamor (Shkolla Artistike)	26	23	55
Balet (Shkolla Artistike)	2	1	69
Biologji	446	420	49.75

Edukim Fizik	396	385	41.68
Fizikë	124	115	64.84
Gjeografi	546	501	57.19
Gjuhë Angleze	706	661	55.24
Gjuhë Frënge	114	111	51.14
Gjuhë Gjermane	33	31	66.42
Gjuhë Greke	3	3	63
Gjuhë Italiane	101	96	56.80
Gjuhë Shqipe Dhe Letërsi	1078	999	59.45
Histori	561	511	58.96
Kimi	167	154	49.84
Matematikë	456	421	56.56
Muzikë	15	14	52.79
Muzikë (Shkolla Artistike)	70	64	53.61
Shkenca Sociale	146	133	53.86
Teknologji Informati Dhe Komunikimi	35	33	48.97
Total	6811	6321	54.60

Bazuar në Udhëzimin Nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë” DPAP organizoi procedurat e portalit “Mësues për Shqipërinë” 2021 në bashkëpunim me QSHA, RASH dhe institucionet e varësisë. Vlen të theksohet që ndryshimi në portalin e këtij viti konsistonte në faktin se vlerësimi i dosjeve të kandidatëve u bë online nga Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve i ngritur në DRAP.

Në tabelën më poshtë paraqitet numri i kandidatëve që kanë aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021 për secilin DRAP.

- Numri i kandidatëve pjesëmarrës në Portalin 2021, sipas DRAP:

DRAP	HYJNË NË TESTIM	MBARTIN PIKËT	SKUALIFIKIME	TOTALI
DURRËS	2733	988	196	3917
FIER	1318	916	99	2333
KORÇË	1974	1019	56	3049
LEZHË	776	313	27	1116
TOTALI	6801	3236	378	10415

PROFILI	NUMRI I KANDIDATËVE NË PORTAL 2021 SIPAS PROFILEVE
Arsimi fillor	1464
Arsimi parashkollor	1059
Arsimi special	66
Art pamor	18
Art pamor (shkolla artistike)	46
Balet (shkolla artistike)	2
Biologji	706
Edukim fizik	501
Fizikë	199
Gjeografi	809
Gjuhë angleze	969
Gjuhë frënge	173
Gjuhë gjermane	51
Gjuhë greke	6
Gjuhë italiane	165

Gjuhë maqedonase	1
Gjuhë shqipe dhe Letërsi	1832
Histori	884
Kimi	283
Matematikë	708
Muzikë	41
Muzikë (shkolla artistike)	113
Shkenca Sociale	253
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	66
Gjithsej	10415

- Punësimi nga portali “Mësues për Shqipërinë”, gjetje/problematika, sfida:
- Mësues të punësuar nga portali “ Mësues për Shqipërinë” 2019,

Nr.	Profili	Të punësuar gjithsej
1	Arsimi parashkollor	78
2	Arsimi fillor	386
3	Arsimi special	17
4	Biologji	88
5	Art pamor	35
6	Edukim fizik	158
7	Muzikë	20
8	Fizikë	42
9	Gjeografi	103
10	Gjuhë angleze	219
11	Gjuhë frënge	41
12	Gjuhë gjermane	12
13	Gjuhë italiane	39
14	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	163
15	Gjuhë greke	10
16	Histori	79
17	Kimi	49
18	Matematikë	141
19	Gjuhë maqedonase	3
20	Shkenca sociale	32
21	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	21
22	Balet (shkolla artistike)	1
23	Art pamor (shkolla artistike)	8
24	Muzikë (shkolla artistike)	24
25	Mësues ndihmës të profileve të tjera, të cilët janë punësuar me kontratë me afat të caktuar.	189
26	Të tjera	39

- Mësues të punësuar nga portali “ Mësues për Shqipërinë” 2020,

Nr.	Profili	Të punësuar gjithsej
1	Arsimi parashkollor	102
2	Arsimi fillor	553
3	Arsimi special	17
4	Biologji	151
5	Art pamor	1
6	Edukim fizik	159
7	Muzikë	18
8	Fizikë	65
9	Gjeografi	148
10	Gjuhë angleze	297
11	Gjuhë frënge	54
12	Gjuhë gjermane	15
13	Gjuhë italiane	50

14	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	398
15	Gjuhë greke	3
16	Histori	156
17	Kimi	63
18	Matematikë	192
19	Gjuhë maqedonase	0
20	Shkenca sociale	65
21	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	35
22	Balet (shkolla artistike)	0
23	Art pamor (shkolla artistike)	20
24	Muzikë (shkolla artistike)	52
25	Mësues ndihmës të profileve të tjera, të cilët janë punësuar me kontratë me afat të caktuar.	129
26	Të tjera	5
		2748

- Numri i punësimeve të kandidatëve pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021, sipas DRAP dhe në total gjatë periudhës Shtator – Dhjetor 2021

DRAP	Punësimet nga portali
Durrës	1501
Fier	869
Korcë	949
Lezhë	500
Totali	3819

- Përmbledhëse e punësimeve të mësuesve nga portali “Mësues për Shqipërinë” në vite

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Të punësuar nga portali	1113	1421	1186	654	1730	1997	2748	3819

- Mësues të punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë” 2021

Nr.	Profili	Të punësuar gjithsej
1	Arsimi parashkollor	102
2	Arsimi fillor	553
3	Arsimi special	17
4	Biologji	151
5	Art pamor	1
6	Edukim fizik	159
7	Muzikë	18
8	Fizikë	65
9	Gjeografi	148
10	Gjuhë angleze	297
11	Gjuhë frënge	54
12	Gjuhë gjermane	15
13	Gjuhë italiane	50
14	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	398
15	Gjuhë greke	3
16	Histori	156
17	Kimi	63
18	Matematikë	192
19	Gjuhë maqedonase	0

20	Shkenca sociale	65
21	Teknologji Informatik dhe Komunikimi	35
22	Balet (shkolla artistike)	0
23	Art pamor (shkolla artistike)	20
24	Muzikë (shkolla artistike)	52
25	Mësues ndihmës të profileve të tjera, të cilët janë punësuar me kontratë me afat të caktuar.	129
26	Të tjera	5
		2748

- Gjetje/problematika të portalit “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2021,

Gjatë funksionimit të portalit, janë vërejtur disa problematika, si më poshtë:

- Renditja në të njëjtën listë e dy kandidatëve të të njëjtit profil, por me diploma në mësuesi AMU dhe AML. Në këtë rast duhet të ketë një ndarje dhe respektim të nivelit arsimor për të cilin IAL e ka certifikuar kandidatin, duke krijuar kështu një mundësi përzgjedhjeje dhe cilësi shërbimi më efektive.
 - Rasti tjetër ka të bëjë me mësues që zotërojnë dy diploma dhe janë licencuar në dy profile. Këtij mësuesi i kufizohet e drejta, pasi ai mund të konkurrojë në të dy profilet aq më tepër kur provimi nuk bëhet në një ditë.
 - Tek njoftimi për zhvillimin e portalit të radhës duhet të listohen dokumentat që duhen rifreskuar nga kandidatët që mbartin pikët, si gjendja gjyqësore, raporti mjeko-ligjor, saktësimi i adresës.
 - Në AMU kandidatët e profilit Muzikë janë kandidatë të cilët në portal janë të licencuar dhe janë emëruar sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 10.06.2021, ndërsa kontingjenti i cili nuk ka disponuar licencën në ushtrimin e profesionit ka aplikuar në portal dhe është kualifikuar vetëm kur ka përzgjedhur konkurrimin për shkollat e mesme artistike. Në rastet kur në AMU nuk ka pasur kandidatë të licencuar ZVAP kanë njoftuar kandidatët e shkollave të mesme artistike, këta të fundit janë punësuar me kontrata me afat të caktuar.
- Rekomandime të portalit “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2021,**

Mbështetur në problematikat e mësipërme, rekomandojmë:

- Afatet për veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve duhet të vendosen në përputhje me ngarkesën dhe rritjen e cilësisë në vlerësimin e dosjeve për të reduktuar në shifra minimale ankimimet për pikët e dosjeve, pasi këtë vit në portal kanë aplikuar në total 10 415 kandidatë, duke bërë krahasim me vitet e kaluara shifrat vijnë gjithmonë e në rritje.
- Lidhjen e sistemit të aplikimit online të kandidatëve “Mësues për Shqipërinë” të RASh-it, me sistemin e gjendjes civile (e-Albania) për të mundësuar aplikimin me NID personal të kandidatëve të saktë si dhe për të shmangur aplikimet e dyfishta të tyre në portal apo aplikimin në 2 profileve.

SFIDA:

Sfidat lidhur me administrimin dhe funksionimin e portalit kanë të bëjnë me digjitalizimin e vijueshëm të tij:

Portali “Mësues për Shqipërinë” edhe pse është një model shumë pozitiv, sepse siguron jo vetëm transparencë dhe efikasitet, meritokraci në punësimin e mësuesve, duhet përmirësuar vazhdimisht në mënyrë që çdo mësues të punësohet sot në arsim vetëm me meritë dhe rezultatet t’i shohim dhe t’i prekim çdo ditë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi ky është vizioni i arsimit të së ardhmes, meritokracia dhe cilësi në mësimdhënie.

III.10 Studime dhe të dhëna parashikuese për vitin shkollor 2021-2022

Gjatë muajve maj-qershor-korrik janë mbledhur të dhëna dhe informacione në funksion të përgatitjes dhe manaxhimit të çdo shtate për vitin shkollor 2021-2022, të tilla si:

- **Parashikim paraprak në lidhje me futjen në programin mësimor të klasave të para të gjuhës angleze.**

Referuar të dhënave statistikore të vitit shkollor 2020-2021, mbi numrin e nxënësve dhe klasave të para në arsimin publik dhe në zbatim të udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, të MASR “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Institucionet e Arsimit Parauniversitar”, pika II, Arsimi Bazë, D “Norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve”- Norma e mësuesve të gjuhëve të huaja (angleze) është 20 orë në javë, u realizua studimi për numrin e mësuesve që nevojiten për zbatimin e kurrikulës së gjuhës angleze nga klasa e parë, si edhe janë përlllogaritur efektet financiare apo shtimin e mësuesve të gjuhës angleze në sistem.

- **Informacion dhe të dhëna për mësuesit ndihmës me vendim pa afat dhe profilet e tyre.**

Bazuar në të dhënat e raportuara nga Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, janë 661 mësues ndihmës me emërim pa afat në sistem, sipas DRAP-ve më poshtë:

DRAP Durrës	DRAP Fier	DRAP Lezhë	DRAP Korçë	GJITHSEJ
143	237	134	147	661

Nga 661 mësuesit ndihmës definitive, vetëm 130 prej tyre kanë përfundur studimet në profilin Arsim special, pra rreth 16 % e tyre, ndërsa pjesa tjetër i përkasin profileve të tjera, ku pjesën më të madhe e zënë profili- Arsim Fillor dhe Gjuhë shqipe dhe letërsi.

- **Mësuesit ndihmës, sipas profileve:**

DRAP	TOTALI
MËSUESVE NDIHMËS ME PROFILE TË TJERA	661
lëndore, mbi të cilat bazohet përmbajtja e testit, hartohen nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Bazuar në këto kompetenca, Qendra e Shërbimeve Arsimore përgatit objektivat e vlerësimit, të cilat lidhen me rezultatet e arritjeve të nxënësve. Provimi i arsimit bazë zhvillohet vetëm me shkrim. Rezultatet e provimeve të kombëtare të arsimit bazë, si një vlerësim i jashtëm i standardizuar, japin të dhënat e nevojshme për të monitoruar sistemin arsimor dhe nivelin e arritjeve të nxënësve, të cilat u shërbejnë mësuesve, specialistëve të arsimit, nxënësve dhe të gjithë të interesuarve në funksion të përmirësimit në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit, Nr. 9, datë 09.04.2021- “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë” 2021 të MASR-së, provimet u zhvilluan në datat e poshtëshënuara:

- a. 11.06.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës amtare
- b. 16.06.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës shqipe
- c. 21.06.2021 u zhvillua provimi i Matematikës
- d. 25.06.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës së huaj

Drejtoria Rajonale dhe Zyrtat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi të tyre monitoruan zbatimin e Rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2021, për planifikimin, organizimin dhe realizimin e gjithë procesit të provimit duke filluar që nga përcaktimi i qendrave të provimit, trajnimin e administratorëve, monitorimin e gjithë procesit të provimit si dhe analizën e plotë të ecures së tyre.

- Qendrat e provimit dhe pjesëmarrja në provimet e PKAB 2021

Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë u planifikuan të zhvilloheshin në 518 qendra provimi.

Këtij provimi do t'i nënshtroheshin rreth 32344 nxënës për çdo lëndë, sipas listave të hartuara nga komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë.

Tabelat e mëposhtme paraqesin të dhëna për numrin e qendrave të provimeve sipas DRAP-ve (ZVAP-ve), numrin e nxënësve që duhej të merrnin pjesë në provim, numrin e mungesave dhe problemeve të konstatuara gjatë katër provimeve.

Pjesëmarrja e nxënësve në provimet PKAB ka qenë 99 %. Më shumë mungesa të nxënësve (në %) ka patur në DRAP Lezhë dhe më pak në DRAP Durrës.

Referuar informacioneve të ardhura nga ZVAP-të, procesi i provimeve është zhvilluar normalisht dhe pa problematika, sipas udhëzimit të MASR-së dhe rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë.

- Informacion për PKAB, lënda Gjuhë shqipe

Nr.	DRAP	Numri i qendrave të provimit	Numri i nxënësve për provim- gjithsej	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	Numri i nxënësve që munguan	Problematika të konstatuara
1	Durrës	168	14731	14568	163	0
2	Fier	108	5904	5817	87	0
3	Korçë	145	6787	6684	103	0
4	Lezhë	97	4922	4836	86	0
Totali		518	32344	31905	439	0

- Informacion për PKAB, lënda Matematikë

Nr.	DRAP	Numri i qendrave të provimit	Numri i nxënësve për provim- gjithsej	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	Numri i nxënësve që munguan	Problematika të konstatuara
1	Durrës	168	14740	14582	158	0
2	Fier	108	5904	5824	80	
3	Korçë	145	6879	6761	118	
4	Lezhë	97	4921	4837	84	Një nxënës i kapur me celular
Totali		518	32444	32004	440	0

- Informacion për PKAB Gjuhë e huaj

Nr.	DRAP	Numri i qendrave të provimit	Numri i nxënësve për provim- gjithsej	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	Numri i nxënësve që munguan	Problematika të konstatuara
1	Durrës	168	14061	13878	183	
2	Fier	108	5901	5802	84	
3	Korçë	144	6877	6754	123	
4	Lezhë	95	4870	4772	98	
Totali		515	31709	31206	488	0

- Informacion për PKAB, lënda Gjuhë amtare-Pakicat kombëtare

NR.	DRAP	ZVAP	Numri i Qendrave të Provimit	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim gjithsej si ZVAP	Problematika të konstatuara
1	Fier	Finiq-Dropull	2	32	0
2		Gjirokastrë- Libohovë	1	9	0

3		Sarandë-Konispol- Delvinë	1	15	0
4		Vlorë-Himarë	1	15	0
5	Korçë	Korçë- Pustec	1	10	0
TOTALI			6	81	0

- Komisioni i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë

Sipas Urdhrit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”, u ngritën komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, të cilat hartuan listën e nxënësve që do të merrin pjesë në provime dhe e dërguan atë në QSHA, trajnuan anëtarët e komisionit shkollor, PAP-et, AP-të, AS-të dhe PK-të, sipas detyrave të caktuara në rregullore dhe plotësuan bazën e të dhënave në sistemin informatik për të gjithë institucionet arsimore të ZVAP-së.

Komisionet e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë përcaktuan mjediset e provimit dhe e dërguan listën në MASR, DPAP, DRAP-e dhe komisione shkollore. Ata hartuan listën e PAP-ve, AP-ve, AS-ve dhe PK-ve dhe të vlerësuesve të testeve sipas lëndëve dhe të kryetarit respektiv të vlerësimit dhe bënë hartën e shpërndarjes së tyre në qendrat e provimit, ku do të zhvilloheshin PKAB-të.

Në ditën e provimit, Komisioni organizoi shortin për caktimin e PAP-ve, i cili u organizua tri orë para fillimit të provimit për zonat urbane dhe një ditë para për zonat rurale.

Gjithashtu KPKAB-të organizuan vlerësimin e testeve në qendrat e vlerësimit të testeve në ZVAP, sipas formatit të ardhur nga QSHA. Rezultatet e vlerësimit u dërguan zyrtarisht në formë elektronike në QSHA.

- Trajnimi i administratorëve

Në zbatim të rregullores së PKAB, për të siguruar një proces normal, të garantuar, transparent, të drejtë dhe të barabartë, komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë kanë zhvilluar trajnime dhe takime me anëtarët e komisioneve shkollore, përgjegjësit e administrimit të provimeve, administratorët e provimeve, administratorët e sekretimit dhe përgjegjësit e kateve.

Në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha ZVAP-et është komunikuar në grupet e krijuara, janë zhvilluar takime online për të zgjidhur çdo problematikë që mund të dalë gjatë provimeve.

- Monitorimi dhe vlerësimi i infrastrukturës së qendrave dhe gatishmëria e tyre për provim

DRAP-et kanë monitoruar ZVAP-et nën juridiksionin e tyre për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe sigurimin e gjendjes teknike të infrastrukturës në qendrat e provimit.

Nga ZVAP-et u krye përmes një instrumenti të posaçëm vlerësimi i qendrave të provimit, për masat e marra dhe gatishmërinë e tyre për të qenë të ajrosura, të pastra dhe të ndriçuara.

Provimi u zhvillua në klasa, sala apo palestra pa materiale me përmbajtje didaktike dhe mësimore të lëndëve që ishin provim dhe me një numër të përcaktuar nxënësish duke ruajtur distancën dhe të gjitha kriteret që duhet të plotësojë një mjedis provimi, sipas rregullores së PKAB-së.

Më poshtë është një përmbledhje e përgjithshme e atyre pak problematikave të hasura në nivel DRAP-i, sipas raportimeve të ardhura nga drejtoritë rajonale apo të dhënave të mbledhura pas çdo provimi me google forms.

- PKAB 2021, sesioni II

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Neneve 26 dhe 50 të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar së Republikës së Shqipërisë” dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 28.07.2021 “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë”, u zhvilluan Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, sezoni i dytë, duke ndjekur procedurat e hartimit dhe vlerësimit të teksteve, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë miratuar me Urdhër Nr. 72, datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë”. Provimet u zhvilluan sipas datave të poshtëshënuara:

- e. 01.09.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës shqipe
- f. 06.09.2021 u zhvillua provimi i Matematikës
- g. 09.09.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës së huaj
- h. 10.09.2021 u zhvillua provimi i Gjuhës amtare

Gjuhët e huaja që u dhanë si provim i detyruar ishin “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht” dhe “Gjermanisht”. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase u ndoqën procedurat e përcaktuara në Pikën 7 dhe 8 të Udhëzimit Nr. 15, datë 28.07.2021 “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë”. Në provimin e lëndës “Gjuhë amtare” të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase si dhe nga instituti i nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, Tiranë, nuk ka patur asnjë nxënës që iu nënshtrua këtyre provimeve në sesionin e dytë.

Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi të tyre monitoruan zbatimin e Rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2021, për planifikimin, organizimin dhe realizimin e gjithë procesit të provimit duke filluar që nga përcaktimi i qendrave të provimit, trajnimin e administratorëve, monitorimin e gjithë procesit të provimit si dhe analizën e plotë të ecurisë së tyre.

Provimet kombëtare të arsimit bazë filluan në orën 10:00 dhe zgjatën 2 orë e 30 minuta.

- Qendrat e provimit dhe pjesëmarrja në provimet PKAB 2021, sesioni i dytë

Në tabelat e mëposhtme gjendet informacioni i detajuar për çdo qendër provimi, për numrin e qendrave të provimeve sipas DRAP-ve, numrin e nxënësve që duhej të merrnin pjesë në provim, numrin e mungesave dhe problemeve të konstatuara gjatë provimeve.

Provimi Kombëtar i Arsimit Bazë, sesioni i dytë për lëndën “Gjuhë shqipe” u planifikua dhe u zhvillua në 42 qendra provimi. Këtij provimi duhej t’i nënshtroheshin 486 nxënës, por vetëm 252 nxënës morën pjesë, kjo sipas listave të hartuara nga komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë. Mungonin rreth 52% e nxënësve.

Provimi për lëndën “Matematikë” u zhvillua në 42 qendra provimi, ku nga 602 nxënës, morën pjesë vetëm 363 nxënës. Mungonin rreth 60% e nxënësve.

Provimi për lëndën “Gjuhë e huaj” u zhvillua në 43 qendra provimi, ku nga 426 nxënës, morën pjesë 241 nxënës. Mungonin rreth 57% e nxënësve.

Pjesëmarrja e nxënësve në provimet PKAB, sesioni i dytë, ka qenë 57 %. Më shumë mungesa të nxënësve (në %) ka patur në DRAP Lezhë dhe më pak në DRAP Fier.

Referuar informacioneve të ardhura nga Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare, procesi i provimeve u zhvillua normalisht dhe pa problematika, sipas udhëzimit të MASR-së dhe rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.

INFORMACION PËR PKAB - GJUHË E HUAJ -SESIONI II –

9 SHTATOR 2021

NR.	DRAP	NUMRI I QENDRAVE TË PROVIMIT	NUMRI I NXËNËSVE PËR PROVIM GJITHSEJ	NUMRI I NXËNËSVE QE MORËN PJESË NË PROVIM	NUMRI I NXËNËSVE QË MUNGUAN	PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA
1	DURRËS	13	180	114	66	0
2	FIER	9	72	44	28	0
3	KORÇË	13	112	56	56	0
4	LEZHË	8	62	27	35	0
TOTALI		43	426	241	185	0

INFORMACION PËR PKAB - MATEMATIKË -SESIONI II –

6 SHTATOR 2021

NR.	DRAP	NUMRI I QENDRAVE TË PROVIMIT	NUMRI I NXËNËSVE PËR PROVIM GJITHSEJ	NUMRI I NXËNËSVE QE MORËN PJESË NË PROVIM	NUMRI I NXËNËSVE QË MUNGUAN	PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA
1	DURRËS	13	288	208	80	0

2	FIER	10	93	62	31	0
3	KORÇË	12	121	64	57	0
4	LEZHË	7	100	29	71	0
TOTALI		42	602	363	239	0

INFORMACION PËR PKAB - GJUHË SHQIPE-SESIONI II –

1 SHTATOR 2021

NR.	DRAP	NUMRI I QENDRAVE TE PROVIMIT	NUMRI I NXËNËSVE PËR PROVIM-GJITHSEJ	NUMRI I NXËNËSVE QE MORËN PJESË NË PROVIM	NUMRI I NXËNËSVE QË MUNGUAN	PROBLEMATIKA TË KONSTATUARA
1	DURRËS	12	191	108	83	0
2	FIER	9	80	54	26	0
3	KORÇË	14	115	60	55	0
4	LEZHË	7	100	30	70	0
TOTALI		42	486	252	234	0

- Komisioni i Provimeve Kombëtare të Arsmit Bazë

Sipas Urdhrit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”, u ngritën komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, të cilat hartuan listën e nxënësve që do të merrin pjesë në provime dhe e dërguan atë në QSHA, trajnuan anëtarët e komisionit shkollor, PAP-et, AP-të, AS-të dhe PK-të, sipas detyrave të caktuara në rregullore dhe plotësuan bazën e të dhënave në sistemin informatik për të gjithë institucionet arsimore të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare.

Komisionet e Provimeve Kombëtare të Arsmit Bazë përcaktuan mjediset e provimit dhe dërguan listën në MASR, DPAP, DRAP-e dhe komisione shkollore. Ata hartuan listën e PAP-ve, AP-ve, AS-ve dhe PK-ve dhe të vlerësuesve të testeve sipas lëndëve dhe të kryetarit respektiv të vlerësimit dhe bënë hartën e shpërndarjes së tyre në qendrat e provimit, ku do të zhvilloheshin Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë.

Në ditët e provimit Komisioni organizoi shortin për caktimin e PAP-ve, i cili u organizua tri orë para fillimit të provimit për zonat urbane dhe një ditë para për zonat rurale.

Gjithashtu KPKAB-të organizuan vlerësimin e testeve në qendrat e vlerësimit të testeve në ZVAP, sipas formatit të ardhur nga QSHA. Rezultatet e vlerësimit u dërguan zyrtarisht në formë elektronike në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.

- Trajnimi i administratorëve

Në zbatim të rregullores së PKAB, për të siguruar një proces normal, të garantuar, transparent, të drejtë dhe të barabartë, komisionet e provimeve kombëtare të arsimit bazë kanë zhvilluar trajnime dhe takime me anëtarët e komisioneve shkollore, përgjegjësit e administrimit të provimeve, administratorët e provimeve, administratorët e sekretimit dhe përgjegjësit e kateve. Materiale për trajnim, video tutoriale dhe instrumente për menaxhimin e provimeve PKAB janë zhvilluar para dhe gjatë provimeve sipas udhëzuesit të hartuar nga QSHA dhe të dërguar në DRAP-e.

Në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha ZVAP-et është komunikuar në grupet e krijuara, janë zhvilluar takime online për të zgjidhur çdo problematikë që mund të dalë gjatë provimeve.

- Monitorimi dhe vlerësimi i infrastrukturës së qendrave dhe gatishmëria e tyre për provim

DRAP-et kanë monitoruar ZVAP-et nën juridiksionin e tyre për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe sigurimin e gjendjes teknike të infrastrukturës në qendrat e provimit.

Nga ZVAP-et u krye përmes një instrumenti të posaçëm vlerësimi i qendrave të provimit, për masat e marra dhe gatishmërinë e tyre për të qenë të ajrosura, të pastra dhe të ndriçuara.

Provimi u zhvillua në klasa pa materiale me përmbajtje didaktike dhe mësimore të lëndëve që ishin provim dhe me një numër të përcaktuar nxënësish duke ruajtur distancën dhe të gjitha kriteret që duhet të plotësojë një mjedis provimi, sipas rregullores së Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë.




Të gjitha provimet kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, u zhvilluan konform Urdhrit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhër Nr. 72, datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë” të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.


IV.16 MATURA SHTETËRORE 2021

Në zbatim të Urdhrit Nr. 364, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit të MASR, Nr. 13, datë 09.07.2021- "Për organizimin dhe zhvillimin e sesionit të dytë të provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2021", janë organizuar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë provimet e Maturës Shtetërore 2021.

Në katër Drejtoritë Rajonale dhe të gjitha Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në varësi, është monitoruar nga DPAP dhe DRAP zbatimi i Rregullores së Maturës Shtetërore 2021, për planifikimin, organizimin dhe realizimin e gjithë procesit që nga përcaktimi i qendrave të provimit, trajnimit të administratorëve, monitorimin ditën e provimit si dhe analizën e plotë të ecurisë së tyre.

Në provimet e Maturës Shtetërore 2021 morën pjesë rreth 34000 nxënës, të 487 institucioneve arsimore, të organizuara në 208 qendra provimi, në 52 ZVAP.





Në zbatim të rregullores së MSH, në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP-të në varësi janë zhvilluar trajnime dhe takime me PAP, AP, AS dhe PK. Materiale për trajnim, video tutoriale dhe instrumenta për menaxhimin e procesit të maturës para dhe gjatë provimit, janë ndërthurur për të siguruar një proces normal dhe për të garantuar për nxënësit një proces transparent, të drejtë dhe të barabartë. Në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha ZVAP-të është komunikuar në grupet e krijuara, janë zhvilluar takime online para dhe pas çdo provimi për t'i ardhur në ndihmë apo zgjidhur çdo problematikë që ka lindur. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar me një instrument të posacëm 24 orë para çdo provimi, nëpërmjet koordinatorëve të ZVAP, ka kryer vlerësimin e qendrave të provimit për masat e marra dhe gatishmërinë e tyre për zhvillimin e procesit dhe më pas e dorëzonin çdo qendër policisë së shtetit. Vlen të theksohet se këtë vit nuk ka pasur asnjë nxënës apo mësues të infektuar me Covid -19. Nga të dhënat e mbledhura për çdo provim, konstatohet se në tre provimet e para pjesëmarrja e nxënësve ka qenë 96 % e dhe në provimin me zgjedhje 97 % ndërkohë nga nxënësit që mungojnë rreth 50% janë të maturantëve mbetës të viteve të kaluara apo nga nxënësit në shkollave me kohë të shkurtuar. Pjesëmarrjen më të lartë në provime e ka DRAP Durrës me 97% dhe më të ulët DRAP Korçë me 95%. Matura Shtetërore 2021 u zhvillua në kushtet e respektimit të masave anticovid.

Specialistët e DPAP-së realizuan me korrektësi dhe profesionalizëm detyrën e ngarkuar për monitorimin e provimeve, duke u bërë faktor për zhvillimin e një procesi cilësor në administrimin e Maturës Shtetërore 2021. Bazuar në vëzhgimin dhe monitorimin e procesit, rezultoi se Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe institucionet arsimore kishin marrë të gjitha masat për realizimin e procesit të provimeve të Maturës Shtetërore konform Rregullores, si me përgatitjen e qendrave të provimit, hedhjen e shortit për përgjegjës adminstrimi i provimit (PAP), adminstrator provimi (AP), përgjegjës kati (PK), oficerë sigurie (OS), duke shmangur konfliktin e interesit. ZVAP-të kishin marrë masat për pajisjen e shkollave me bllokues valësh, por në disa raste ato ishin të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha mjediset. Identifikimi i maturantëve u bë i plotë nëpërmjet mjetit të identifikimit.

DPAP	QËNDRA PROVIMI	MATURANTËVETË REGJISTRUAR SIPAS QSHA	MATURANTË QË MORËN PJESË NË TESTIM	MATURANTË QË MUNGUAN NË TESTIM	SA NGA MUNGESAT JANE MBETËS OSE PK	MATURANTË TË LARGUAR PËR CELULARË	MATURANTEVE TE LARGUAR PROBLEME TE TJERA	LARGIME ADMINISTRATORE
GJUHË E HUAJ								
SESIONI 1	208	33811	32578	1233	669	6	0	0
SESIONI 2	35	3444	2439	1005	269	0	0	0
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI								
SESIONI 1	208	34130	32804	1329	664	5	1	1
SESIONI 2	35	3184	2148	1036	140	0	0	0
MATEMATIKË								
SESIONI 1	208	33764	32474	1290	655	8	0	0
SESIONI 2	37	4323	3231	1092	149	0	0	0
LËNDË ME ZGJEDHJE								
SESIONI 1	208	33871	32744	1101	463	11	0	1
SESIONI 2	35	3266	2210	1056	160	0	0	0

IV.17 PROGRAMI KOMBËTAR “ARTET DHE ZEJET NE SHKOLLË”

Gjatë muajit tetor 2021 specialistë të DPAP-se ishin pjesë e hartimit të Udhëzuesit për zbatimin e programit “Edukimi për artet, zejet dhe sportin” që do të jetë një material ndihmës për institucionet arsimore me qëllim që të mbështesë institucionet arsimore për zhvillimin e veprimtarive me nxënësit që do të ndjekin programin “Edukimi për artet, zejet dhe sportin” si dhe t’u vijë në ndihmë ZVAP-e dhe DRAP-ve për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive të shkollave të angazhuara në zbatimin e këtij programi.

Në lidhje me programin Art dhe zeje në shkollë, DPAP në bashkëpunim me ASCAP, mbështetur në pikat e takimit me kryeministrin, hartoi një pyetësor në Googleforms për të marrë informacion të drejtpërdrejt nga institucionet arsimore të arsimit parauniversitar. Pas plotësimit nga 1130 IAP u dërgua në zbatim të planit të punës të ASCAP.

Gjithashtu, gjatë muajve nëntor-dhjetor në zbatim të planit të veprimit janë marrë të dhëna ndihmëse nga DRAP/ZVAP për mësuesit e Artit Pamor, Muzikë, Teatër, Edukim Fizik, Aftësim Teknologjik, Tik për të gjitha IAP në juridiksionin e tyre dhe janë dërguar në ASCAP.

IV.18 SHËRBIMI PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR 2021

Punonjësit e shërbimit psiko-social gjatë vitit shkollor 2020-2021 e në vijim të vitit të ri shkollor 2021-2022, kanë pasur qëllim kryesor mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve në kushtet e zhvillimit të mësimi me skenarë dhe të zbatimit të protokolleve të sigurisë kundër COVID-19. Gjithashtu edhe parandalimin e përfshirjes së nxënësve në sjellje të rrezikshme dhe parandalimin e fenomenit të bullizmit, sidomos atij kibernetik. Për realizimin e këtyre synimeve dhe menaxhimin e problematikave të paraqitura në lidhje me sjelljen dhe disiplinën, komunikimin bashkëmoshatar, efektet psikologjike të lojrave online, gjendjen emocionale dhe vetvlerësimin, frekuentimin, rezultatet mësimore, aftësia e kufizuar, probleme të mbrojtjes së fëmijës, probleme të komunikimit prind- fëmijë dhe vecanërisht pasojat e traumës dhe periudha e distancimit fizik për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID -19 është arritur të bashkëpunohet në mënyrë efektive me:

- Drejtorinë e shkollës dhe stafet e mësuesve
- Qeverinë e nxënësve
- Personelin jo arsimor.
- Prindërit.
- Komisioni i institucionit arsimor për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Njëkohësisht, vlen të përmendet se puna e çdo punonjësi është mbështetur në Planin vjetor të NJSHPS, udhëzimet e MASR, ZVAP-ve dhe në strategjitë e mëposhtme të cilat janë mbajtur në fokus gjatë planifikimit vjetor të çdo punonjësi :

- Strategjinë kombëtare për minoritetin rom dhe egjiptian.
- Strategjinë kombëtare për personat me AK.
- Strategjinë kombëtare antitrafik.
- Strategjia kundër drogës dhe alkoolit.
- Strategjia kombëtare për barazinë gjinore.
- Strategjia kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- Strategjia “Stop dhunës në shkollë”.
- Strategjia për internet të sigurt.

- Strategjia për edukimin ligjor.
- Strategjia për drejtësinë për të mitur.

- **Njësia dhe organizimi i saj**

Bazuar në udhërin nr. 313, datë 22.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social” është bërë dhe riorganizimi i këtij shërbimi duke dyfishuar numrin e punonjësve në institucionet arsimore në vend.

Aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar janë të punësuar 634 punonjës të shërbimit psiko-social, konkretisht:

DRAP	Psikolog	Punonjes Social
DURRËS	198	107
FIER	60	36
KORÇË	81	63
LEZHË	65	24
GJITHSEJ	404	230

Shpërndarja e tyre në institucionet arsimore është kryer sipas Udhëzimit nr 313; kreu II; pika 4; ku citohet:

- a) një psikolog/punonjës socialë mbulon 500 – 700 nxënës
- b) dy psikolog/punonjës socialë për cdo shkollë me mbi 700 nxënës

Me rritjen e punonjësve të shërbimit dhe me uljen e numrit të nxënësve në mbulim, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimit të ofruar, duke fuqizuar rolin e tyre brenda institucioneve arsimore në bashkëpunim me stafet drejtuese dhe pedagogjike. Numri i punonjësve SHPS aktualisht është në përputhje me normat e përcaktuara dhe deri më tani ky shërbim ka funksionuar rregullisht duke qenë prezent në shkollë, pranë nxënësve apo mësuesve në rast nevojë.

I. Parandalimi

a. Të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e punonjësve në IA

Gjatë këtij viti shkollor punonjësit e shërbimit psiko-social kanë grumbulluar në mënyrë periodike të dhëna mbi veprimtaritë e kryera në institucionet arsimore.

Temat e aktiviteteve parandaluese janë përzgjedhur duke i'u referuar planit të njësisë SHPS, kalendarit të aktiviteteve dhe nevojave të vlerësuara në institucionet arsimore. Përmbledhja e të dhënave statistikore paraqitet në tabelën vijuese:

Nr	Përshkrimi	Gjithsej
1	Nr.i aktiviteteve ndërgjegjëse me nxënës	14604
2	Nr.i aktiviteteve ndërgjegjëse me mësues	2157
3	Nr.i aktiviteteve ndërgjegjëse me prindër	1473
4	Nr.i këshillimeve individuale me nxënës	10177
5	Nr.i këshillimeve individuale me mësues	4753
6	Nr.i këshillimeve individuale me prindër	4764
7	Nr.i këshillimeve në grup me nxënës	3396
8	Nr.i këshillimeve në grup me mësues	1748
9	Nr.i këshillimeve në grup me prindër	757
10	Nr.i pyetësorëve me nxënës.	1832
11	Nr.i pyetësorëve me mësues.	427
12	Nr.i pyetësorëve me prindër.	386
13	Nr .i rasteve të referuara në NJSHPS.	373
14	Nr.i rasteve për të cilat është kryer një vlerësim psikologjik (nga psikologët)	2357
15	Nr.i rasteve për të cilat është kryer vlerësim i gjëndjes së nxënësit (nga punonjësi social)	1229
16	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga nxënësit të referuara në drejtori	556
17	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga mësues të referuara në drejtori	146
18	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga prindër të referuara në drejtori	79
19	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga nxënës të referuara në NJSHPS	143
20	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga mësues të referuara në NJSHPS	37
21	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga prindër të referuara në NJMF	65
22	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga nxënës të referuara në polici	82
23	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga mësues të referuara në polici	3
24	Nr.i rasteve të dhunës të shkaktuara nga prindër të referuara në polici	30
25	Nr.i rasteve me simptoma psiko-emocionale tek nxënësit.	2265
26	Nr.i dosjeve të reja	2881
27	Nr.i dosjeve në vazhdim	2939
28	Nr.i dosjeve të mbyllura	1813
29	Nr.i dosjeve të transferuara në shkolla të tjera.	78
30	Nr.i këshillimeve të nxënësve nga COVID-19.	1681

31	Nr.i pyetësorëve të realizuar	3971
----	-------------------------------	------

b. Tematika e pyetësorëve

- Qëndrimet dhe sjelljet mbi përdorimin e substancave.
- Vlerësimi i gjendjes psiko-emocionale të nxënësve.
- Ankthi i krijuar nga provimet.
- Bullizmi
- Dhuna në familje në periudhën Covid
- Disiplina pozitive dhe prindërimi pozitiv.
- Disiplina pozitive në klasë
- Disiplina pozitive tek fëmijët
- Drogat, duhani, alkooli
- Ekstremizmi i dhunshëm.
- Etika në marrdhëniet në shkollë
- Evidentimi i cilësisë së shërbimit që ofron shkolla.
- Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e arsimit të mesëm profesional/të përgjithshëm.
- Frikrat Sociale
- Gjendja emocionale e fëmijëve në fillim të vitit shkollor.
- Gjendja emocionale e nxënësve. Stresi nga Covid-19.
- Gjendja psiko emocionale e nxënësve gjatë vitit shkollor
- Gjendja psiko-emocionale e nxënësve para provimeve
- Identifikim i mundësive dhe nevojave për përmirësim të mëtejshëm të gjithpërfshirjes në arsim (pyetësor me mësues)
- Siguria në internet.
- Klima e përgjithshme brenda në shkollë dhe zbatimi i rregullores për të gjithë

- Varësia nga teknologjia etj

II. Rezultatet e arritura gjatë punës vjetore për të gjitha problematikat e sipër-përmendura:

- Përfshirja e numri të madh të nxënësve në këshillim individual, këshillim në grup, konsulta, biseda në grup, seminare në klasë dhe aktivitete të ndryshme sipas problematikës së referuar nga nxënësit në përputhje me moshën e tyre (fizikisht në mjediset e shkollës dhe online).
- Ndërhyrje të suksesshme duke bashkëpunuar me drejtuesit e shkollës dhe mësuesit kujdestarë, në zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet bashkëmoshatore, problemet e sjelljes me nxënës-mësues, lehtësim të problemeve prind-fëmijë, ndihmë për viktimat e bullizmit.
- Ndihmë profesionale për mësuesit dhe prindërit në raste të kapërcimit të problemeve me nxënës që shfaqin vështirësi në klasë dhe në shtëpi, hartimi i strategjive dhe planeve individuale për nxënës me AK.
- Fuqizimi i rolit të psikologut dhe përmirësimi i shërbimeve të tij në shkollë, mësuesit e konsiderojnë partner në punën e tyre me nxënësit dhe Qeveria e Nxënësve e shikon si aleat për të përcjellë te stafi pedagogjik të gjitha shqetësimet dhe dëshirat e nxënësve por edhe si bashkëpunëtor në realizimin e veprimtarive të ndryshme.
- Rritja e nivelit të informimit të nxënësve për fenomene të ndryshme që preken në fëmijëri dhe adoleshencë si dhe ndërgjegjësimi i tyre mbi rrezikshmërinë dhe pasojat për moshën e tyre (drogën, Hiv-Aids, dhuna , negociim konflikti, stresi dhe ankthi nga provimet, shëndeti mendor, dhe problemet e shëndetit fizik dhe mendor).
- Bashkëpunimi me NJMF.
- Rritja e numrit të konsultimeve me prindërit, kryesisht ata që kanë fëmijë me AK dhe jo vetëm.
- Pavarësisht se procesi mësimor është zhvilluar me skenarë të ndryshëm për cdo institucion është arritur të realizohet një punë cilësore nga i gjithë stafi në funksion të mësimin në distancë dhe të alternuar dhe në ndihmë të nxënësve për të përballuar situatën në pandemi.
- **Vështirësitë e ndeshura gjatë punës në shkollë dhe gjatë organizimit të punës nga njësia:**
 - Mungesa e protokolleve të punës për rastet e dhunës, abuzimit dhe trajtimit problematikave të shëndetit mendor
 - Qartësimi i ndarjes së roleve të psikologut/ punonjësit social

- Mungesa e mjediseve konfidenciale të punës (në pjesën më të madhe të rasteve ndahet me mjekun, oficerin e sigurisë, etj).
- mungesa e paisjeve të zyrës (kompjuter, printer, fotokopje, internet).
- vështirësi për të hartuar planet e ndërhyrjes në mënyrë të përshtatshme për nxënësit në kushte e pandemisë.
- Shumë punonjës kanë ende vështirësi të gjejnë kohën e përshtatshme dhe orarin e duhur për këshillimin e nxënësve.
- Rezistencë nga ana e nxënësit me sjellje problematike për t'u trajtuar, familja ka raste kur tërhiqet dhe nuk merret me fëmijën ose/ dhe nuk merr në konsideratë orjentimet e dhëna nga personeli i shkollës.
- Jo gjithmonë referimi i rasteve ka gjetur zgjedhje të problematikës.
- Mungesa e mjeteve diagnostikuese/vlerësuese për rastet e shëndetit mendor.
- Mungesa e kohës për të punuar me nxënësit që shfaqin nevojën për shërbim psikologjik.
- Mungesa e një fondi monetar në funksion të aktiviteteve të zhvilluara për grupime të caktuara nxënësish.
- Mungesa e mjeteve të vlerësimit psikologjik, vecanërisht kur duhet të punojmë me fëmijët e ciklit të ulët.
- Mqs problematikat sjellore/ emocionale janë më të dukshme në AMU është shpenzuar më shumë kohë duke ofruar shërbimin psikologjik për ta krahasuar me arsimin fillor.
- Këtë vit ka qenë e vështirë të realizohet vlerësimi i brendshëm i punës së psikologut në shkollë.

➤ **Arritje pozitive të dukshme:**

- Fryma e bashkëpunimit për menaxhimin e situatave të ndryshme.
- Hartimi i planeve individuale të ndërhyrjes për nxënësit me problematikë të vështirë, me probleme emocionale, probleme të sjelljes dhe disiplinës.
- Ndhurma profesionale të mësuesit që kanë nxënës me sjellje të vecantë.
- Konsulta me psikologët e shkollave që kanë problematika të njëjta.

➤ **Bashkëpunime:**

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me stafin drejtues të shkollës, mësuesit dhe fryma pozitive e bashkëpunimit.

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Qeverinë e Nxënësve.
- Bashkëpunim efektiv me Njësinë e Shërbimit Psiko-Social Shkollor dhe supervizoret.
- **Komisioni Multidisiplinar dhe mësuesit ndihmës**

Bazuar në rregulloren 31, datë 21.01.2020 “Për miratimin e rregullores 31 për funksionimin e institucioneve arsimore paraniversitare në Republikën e Shqipërisë” çdo fillim viti shkollor, drejtuesit e zyrave vendore arsimore me një urdhër të brendshëm, ngrenë Komisionet Multidisiplinare në çdo ZVAP, i cili është i përbërë prej pesë anëtarësh për të shqyrtuar kërkesat e prindërve dhe institucioneve arsimore me qëllim vlerësimin e nevojave arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuar

- Dosja e vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta përmban:
 - Vlerësimin e nevojave nga komisioni i AK,
 - Raportin e caktimit të aftësisë për punë me diagnozë të specifikuar, një vlerësim nga psikologu i shkollës, planin PEI.

Për nxënësit që u vlerësuan për herë të parë nga komisioni, nevojat vlerësohen nëpërmjet një formati vlerësimi të nevojave arsimore, sociale dhe një vlerësim i gjithanshëm i fushave të zhvillimit.

Për nxënësit që janë vlerësuar dhe më parë aplikohet një format rivlerësimi në të cilën vlerësohet ecuria e nxënësve në bazë të objektivave të përcaktuara në planin PEI duke përcaktuar numrin e orëve të nevojshme dhe rekomandime për punën në vijim.

Për rastet e tjera që shfaqin aftësitë bazë të të nxënësve, të socializimit dhe qëndrimit në ambjentin e klasës, rekomandohet të ndjek arsimin e zakonshëm dhe sipas rastit rekomandohet për orët që duhet të ndiqet me mësues ndihmës (orët përcaktohen rast pas rasti në bazë të nevojave).

Nxënës me aftësi të kufizuar që janë vlerësuar nga komisioni multidisiplinar dhe numri i mësuesve ndihmës, sipas rekomandimit që është dhënë në momentin e vlerësimit për vitin shkollor 2021-2022 është si më poshtë:

DRAP	NUMRI I NXËNËSVE ME AK	NUMRI I MËSUESVE NDIHMËS	M.NDIHMËS ME ARSIM SPECIAL	M.NDIHMËS ME PROFIL TË PËRAFERT
DURRËS	1409	477	42	435
FIER	660	442	59	383
KORCË	866	323	16	307
LEZHË	487	240	16	224
TOTAL	3417	1482	133	1349

Problematika të vlerësuara nga komisioni i shkollës

- Mungesa e paisjes me raport mjeko-ligjor të disa nxënësve me nevoja të veçanta, sjellë dhe pamundësinë nga ana e komisionit për të rekomanduar orë me mësues ndihmës dhe kur kjo nevojë është e dukshme.
- Mungesa e dëshirës së disa prindërve për të ndjekur rekomandimin e komisionit për ndjekjen e përkohshme të arsimit special për nxënës që paraqesin nevojën për ndërhyrje më të specializuar.
- Mungesa e mjeteve didaktike, mungesë e hapësirave burimore/zhvillimore, vështirësi në koordinimi/bashkëpunim me prindërit për zbatimin e objektivave të vendosura në PEI.

- Mësuesit ndihmës dhe puna me nxënësit me ak

Çdo nxënës i vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar shoqërohet gjatë procesi mësimor me mësues ndihmës sipas rekomandimeve të dhëna nga komisioni multidisiplinar për numrin e orëve, hartimin e planit PEI dhe specifika të tjera individuale të nxënësve.

Bazuar në udhëzimin Nr.26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar” çdo mësues ndihmës asiston 2-3 nxënës gjatë procesi mësimor duke dhënë mbështetjen e tij në ato lëndë për të cilat është hartuar plani PEI.

Në funksion të gjithëpërfshirjes dhe integritetit të këtyre nxënësve me bashkëmoshatarët, mbështetja nga mësuesit ndihmës u ofrohet nxënësve kryesisht në mjediset e klasës me përjashtime të disa rasteve kur Komisioni Multidisiplinar ka rekomanduar që kjo mbështetje të alternohet veç mjedisit të klasës edhe në klasën burimore apo mjedise të tjera të shkollës (si palestra, oborri, salla aktivitetesh, etj.)

Për realizimin e vlerësimit të ecurisë sipas fushave të përcaktuara në planin PEI, mësuesit ndihmës, bashkëpunojnë ngushtë me mësuesit kujdestarë dhe ata lëndore, me psikologun/punonjësin social dhe prindërit për të nxitur zhvillimin sa më të plotë të potencialit social-emocional, njohës dhe zhvillimor të këtyre nxënësve e në të njëjtën kohë me çdo aktor tjetër që mund të lehtësojë gjithëpërfshirjen dhe integritetin e nxënësve me AK në çdo aktivitet të klasës apo shkollës, në përputhje me aftësitë, nevojat dhe interesat e fëmijës.

Komunikimi i vazhdueshëm me prindërit dhe bashkëpunimi me ta për nxitjen dhe arritjen e objektivave sjellorë dhe lëndorë, lejon mësuesit ndihmës të mbështesin nxënësit me AK në zhvillimin e aftësive për jetën dhe nxitjen e tyre për arritjen e pavarësisë.



IV.19 IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE TË NXËNËSVE PËR PËRMIRËSIM



Në vijim të shkresës Nr.2483 prot., datë 30.04.2021 “Për zbatim”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila ka hartuar planin e veprimit “Për zhvillimin e arritjeve të nxënësve, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësimin e tyre, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid

– 19”, në javën e fundit të muajit maj u zhvilluan teste për klasat I-IV, VI-VIII- dhe X-XI. Këto teste ishin diagnostikuese dhe nuk janë vlerësuar me notë.

Për të marrë një informacion më të saktë për të hartuar raportin mbi njohuritë dhe aftësitë për të cilat nxënësit do të kishin rezultate më të ulëta dhe që kanë nevojë për përsëritje, përforsim, konsultime nga ana e nxënësve, DPAP ngriti grupe pune për të përcaktuar të gjitha rezultatet e të nxënësit që janë përdorur nga programet orientuese për hartimin e testeve për secilën lëndë dhe klasë.

Për të gjitha testimet pas vlerësimit të tyre dhe pas përpunimit të të dhënave, rezultatet e të nxënësit ku nxënësit kanë paraqitur rezultatet më të ulëta dhe që kanë nevojë për përsëritje, përforsim, konsultime ju paraqitën të detajuara ASCAP dhe MASR mbi të cilat u përgatitën Udhëzuesit për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.





Në zbatim të pikës 3, të rubrikës 1.2 “Arsimi Bazë” të Udhëzimit të përbashkët nr. 17, datë 16.08.2021, për vitin shkollor 2021-2022, në sistemin parauniversitar, nga datat 01-10.09.2021 u morën masa për përsëritje të temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë.

V. VEPRIMTARI MONITORESE DHE VLERËSUESE PËR VITIN 2021

V.1 Të dhëna të përgjithshme mbi numrin e monitorimeve, vlerësimeve për vitin 2021

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MASR.

DPAP ka zhvilluar funksionet e saj me veprimtari, të tilla si:

- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar;
- Vlerësimi i njësive arsimore vendore në arsimin parauniversitar;
- Vlerësimi i drejtorive rajonale në arsimin parauniversitar;

- Kontrolli i pajtueshmërisë të veprimtarive të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore;
- Monitorimi i teksteve shkollore;
- Monitorimi i zbatimit të Rregullores për funksionimin e IAP;
- Vlerësim i IA, për zbatimin e masave anti- Covid 19,
- Monitorimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar,
- Informimi i Ministrit, njësive arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e vlerësimeve të institucioneve arsimore;
- Inspektime bazuar në ankesa;
- Trajtim ankesash, etj.

Për vitin 2021, nuk janë realizuar të gjitha veprimtaritë e planifikuara për shkak të situatës Covid-19, por janë realizuar edhe vlerësime/monitorime si më poshtë vijon:

Nga DPAP janë kryer **184** monitorime/vlerësime gjithsej.

Për muajin **janar 2021** janë kryer 20 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe është propozuar 1 masë nga DPAP. Tematikat apo qëllimi i vlerësimit është fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Vlerësim i IA, për zbatimin e masave anti- Covid 19,
- Vlerësimi i cilësisë së hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm dhe vjetor si dhe Rregullores së brendshme të IAP,

Për muajin **shkurt 2021** janë kryer 17 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe janë propozuar 6 masa. Tematikat apo qëllimi i vlerësimit është fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Monitorimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar,
- Vlerësimi i IAP-ve bazuar në ankesa,
- Vlerësimi i cilësisë së hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm dhe vjetor të IAP,
- Verifikimi zbatimit të masave anti COVID-19 dhe cilësia e realizimit të veprimtarisë mësimore edukative në përputhje me skenarin 2,
- Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi,
- Verifikimin e dokumentacionit të institucionit arsimor privat “Odisea”, Mallakastër, vlerësimi i zbatimit të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr.15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar,

Për muajin **mars 2021** është kryer 1 vlerësim nga DPAP dhe është propozuar 1 masë. Tematikat apo qëllimi i vlerësimit është fokusuar kryesisht si më poshtë vijon:

- Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat dhe funksionimit të tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi,

Për muajin **prill 2021** janë kryer 17 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe janë propozuar 2 masa.

- Monitorimi i IA për zbatimin e Urdhërit Nr.46, datë 16.03.2021 “Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollos 2021-2022”,
- Trajtim ankese e mësueses M.B,
- Monitorimi i ZVAP-së për procedurat e ndjekura për kualifikimin e mësuesve 2021,

Për muajin **maj 2021** janë kryer 19 vlerësime/monitorime nga DPAP.

- Verifikim dhe trajtim i ankesës për mësuesen e profilit Bio-Kimi V.P., në IAP gjimnazi "Isa Boletini", Paskuqan.
- Trajtim ankese PLM Vlorë.
- Verifikimi dhe trajtimi i ankesës për mësuesen V.P në gjimnazin “Isa Boletini”, Paskuqan.
- Zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe për marrjen e masave për Maturën Shtetërore nga IAP-të”.
- Monitorim i procesit të VANAF në ZVAP-e dhe IAP.

Për muajin **qershor 2021** janë kryer 2 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe janë propozuar 1 masë për ZVAP Kukës dhe për drejtues të IA.

- Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik.

Për muajin **korrik 2021** janë kryer 9 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe janë propozuar 3 masa.

- Vlerësimi i DRAP-ve për procedurën e ndjekur për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në Portalin Mësues për Shqipërinë.
- Vlerësimin e veprimtarive të IAP.
- Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Për muajin **gusht 2021** është kryer 1 vlerësim/monitorim nga DPAP dhe është propozuar 1 masë.

- Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Për muajin **shtator 2021** janë kryer 16 vlerësime/monitorime nga DPAP.

- Monitorimi dhe vlerësimi i IA në arsimin parauniversitar për zbatimin e masave anti COVID– 19 dhe për organizimin dhe realizimin e mësimit plotësues, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Për muajin **tetor 2021** janë kryer 12 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe është propozuar 1 masë.

- Vlerësimi i veprimtarisë dhe zbatueshmërisë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të institucionit arsimor parauniversitar privat.
- Monitorimi i IA-ve për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar.

Për muajin **nëntor 2021** janë kryer 37 vlerësime/monitorime nga DPAP dhe është propozuar 1 masë.

- Monitorimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar.
- Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: “Drejtimi dhe menaxhimi”.
- Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit parauniversitar publik “Dhaskal Todri”, Elbasan.
- Trajtimi dhe vlerësimi i ankesës së Znj. M.Xh., në Institucionin Arsimor Parauniversitar Shkolla e Mesme e Bashkuar “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik.
- Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrove Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik.

Për muajin **dhjetor 2021** janë kryer 33 IA vlerësime/monitorime nga DPAP.

- Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushat “Drejtimi dhe menaxhimi” në bashkëpunim me ASCAP dhe DRAP.
- Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit publik, të arsimit parauniversitar.
- Trajtimi dhe vlerësimi i ankesave në institucionet arsimore parauniversitare shkolla 9 – vjeçare private “Mësonjëtorja Dertliu”, Fier dhe SHMB "Fier Sëman", Divjakë.

Në përfundim të monitorimeve/inspektimeve janë dhënë rekomandimet përkatëse.

V.2 Të dhëna mbi shpërndarjen e monitorimeve/vlerësimeve sipas ZVAP-ve

DPAP-ja gjatë monitorimit dhe vlerësimit të IAP-ve për vitin 2021 ka realizuar:

➤ Monitorime të IAP-ve dhe ZVAP-ve si më poshtë vijon:

- 37 monitorime në IAP-të në varësi të ZVAP Tiranë, prej të cilave 4 në IAP private,
- 7 ZVAP përkatësisht: ZVAP Kamëz, ZVAP Vorë, ZVAP Elbasan, ZVAP Tiranë, ZVAP Durrës, ZVAP Shijak, ZVAP Kavajë.

➤ Vlerësime /inspektime të IAP-ve ka realizuar sipas shpërndarjes si më poshtë vijon:

Për DRAP Durrës:	Për DRAP Korçë:	Për DRAP Fier:	Për DRAP Lezhë:
- 14 IAP në varësi të ZVAP Kamëz, - 21 IAP në varësi të ZVAP Tiranë, - 7 IAP në varësi të ZVAP Bulqizë, - 8 IAP në varësi të ZVAP Durrës,	- 14 IAP në varësi të ZVAP Pogradec, - 9 IAP në varësi të ZVAP Korçë, - 5 IAP në varësi të ZVAP Librazhd, - 3 IAP në varësi të ZVAP Elbasan,	- 9 IAP në varësi të ZVAP Sarandë-Konispol- Delvinë, - 2 IAP në varësi të ZVAP Lushnjë, - 4 IAP në varësi të ZVAP Kavajë, - 2 IAP në varësi të ZVAP Fier,	- 2 IAP në varësi të ZVAP Krujë, - 4 IAP në varësi të ZVAP Shkodër.

➤ **Vlerësime /inspektime bazuar në ankime ka realizuar sipas shpërndarjes si më poshtë vijon:**

- 1 IAP në varësi të ZVAP Tiranë,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Cërrik,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Vlorë,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Kamëz,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Malësi e Madhe,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Divjakë.

➤ **Vlerësime /inspektime në IAP private ka realizuar sipas shpërndarjes si më poshtë vijon:**

- 4 IAP në varësi të ZVAP Tiranë,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Durrës,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Tiranë,
- 6 IAP në varësi të ZVAP Fier,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Lushnjë,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Mallakastër,
- 1 IAP në varësi të ZVAP Roskovec.

➤ **Vlerësime /inspektime në ZVAP ka realizuar sipas shpërndarjes si më poshtë vijon:**

- ZVAP Bulqizë,
- ZVAP Has,
- ZVAP Pukë,
- ZVAP Kukës,
- ZVAP Cërrik,
- ZVAP Elbasan,
- ZVAP Malësi e Madhe.

➤ **Vlerësime /inspektime në DRAP ka realizuar sipas shpërndarjes si më poshtë vijon:**

- DRAP Korçë
- DRAP Lezhë
- DRAP Durrës
- DRAP Fier

V. 3. Monitorimi i IA për procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore për vitin shkollor 2021-2022

Nga DPAP u zhvillua monitorim/vlerësim me tematikë: “Monitorimi i IA për zbatimin e Urdhërit Nr.46, datë 16.03.2021 “Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022” dhe për këtë tematikë u monitoruan/vlerësuan shkollat si më poshtë vijon:

1. Shkolla 9-vjeçare "1 Maji", Tiranë
2. Gjymnazi “Ismail Qemali”, Tiranë
3. Shkolla 9-vjeçare “Dëshmorët e Lirisë”, Tiranë
4. Gjymnazi "P.N.Luarasi", Tiranë
5. Shkolla 9 - vjeçare “Vasil Shanto", Tiranë
6. Gjymnazi "Besnik Sykja", Tiranë

7. Gjymnazi "Partizani", Tiranë
8. Shkolla 9-vjeçare "E kuqe", Tiranë
9. Shkolla 9 - vjeçare "Ahmet Gashi", Tiranë
10. Shkolla 9 - vjeçare "28 Nëntori", Tiranë
11. Gjymnazi "Aleks Buda", Tiranë

Në përfundim të monitorimit/vlerësimit u konstatua se:

- Këshillat e mësuesve të shkollës janë njohur me përmbajtjen Urdhrit Nr.46, datë 16.03.2021 "Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022", dhe katalogun bashkëlidhur këtij Urdhri.
- Shkollat disponojnë katalogun e teksteve si dhe kopjet e teksteve shkollore të dërguara nga botuesit të cilat janë inventarizuar në bibliotekat e tyre.
- Shkollat kanë ngritur Komisionin e Administrimit të përzgjedhjes së teksteve shkollore, të përbërë nga tre anëtarë.
- Shkollat kanë shpallur datën, orën, vendin, si dhe rendin e ditës të mbledhjes për përzgjedhjen e teksteve shkollore.
- Në shkollat e monitoruara nga DPAP, mësuesit e shkollës janë grupuar sipas komisioneve lëndore, përkatësisht sipas specifikave të çdo shkolle.
- Shkollat disponojnë procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve shkollore të çdo komisioni lëndor, të nënshkruar nga të gjithë mësuesit në komision.
- Dokumentacioni i administrimit të teksteve shkollore është ruajtur në arkivin e shkollës për 2 vite kalendarike, në të gjitha institucionet e monitoruara nga DPAP.
- Shkollat nuk kanë lejuar asnjë veprimtari të shtëpive botuesve për publicitetin e teksteve të tyre gjatë procesit të përzgjedhjes.

IV.4. Monitorimi i institucioneve arsimore për zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe për marrjen e masave për Maturën Shtetërore

Nga DPAP u zhvillua monitorime/vlerësime me tematikë: "Zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe për marrjen e masave për Maturën Shtetërore nga IAP-të". Institucionet arsimore që u monitoruan/vlerësuan janë si më poshtë vijon:

1. Gjymnazi "Sadi Nuri", Ndroq, Tiranë
2. Shkolla jo publike "Arsakeio", Tiranë
3. SHMB "Ymer Lala" Surrel, Tiranë
4. SHMB Farkë, Tiranë
5. Shkolla jo publike "Harry Fultz", Tiranë
6. Gjymnazi "Sadik Stavaleci", Katundi Ri, Tiranë
7. Shkolla jo publike "Viktor Hygo", Tiranë
8. SHMB "Vaqarr", Tiranë
9. Shkolla jo publike "Rreze Drite", Tiranë

10. Shkolla "Isa Boletini", Paskuqan, Tiranë

Në përfundim të monitorimit/vlerësimit për institucionet arsimore u konstatua se për:

Treguesin 1. Shkolla ka marrë masat për zbatimin e masave anti COVID-19.

- Shkollat kanë hartuar planin për hyrjen dhe daljen e nxënësve, për distancimin fizik, si dhe ka realizuar piketimin apo vijëzimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme (në korridore) duke respektuar masat anti COVID-19.
- Shkollat kanë afishuar rregullat për lëvizjen e nxënësve dhe mësuesve, posterat për rregullat e higjienës në gjithë mjediset e saj.
- Shkollat kanë realizuar vendosjen e nxënësve në klasë duke respektuar largësinë 1.5 m nga njëri-tjetri.
- Shkollat kanë marrë masa për dezinfektimin e ambienteve të tyre, si dhe higjienizimin e rregullt të ambienteve kryer nga punonjësit e shërbimit të institucionit arsimor.
- Në shkolla ka ujë të rrjedhshëm, dhe energji elektrike pa ndërprerje.
- Shkollat kanë hartuar orarin për hyrjen e nxënësve në të, përmes një grafiku duke përfshirë dhe monitorimin nga mësuesit, si dhe ka përcaktuar mësuesit përgjegjës për matjen e temperaturës me termometër digjital.
- Shkollat kanë punuar Udhëzuesin e ASCAP për fillimin e vitit shkollor 2020-2021, me mësuesit, bazuar në proceverbalin e datës 10.09.2020.
- Shkollat kanë hartuar plane të detajuara për zbatimin e skenarit të përzgjedhur prej tyre.

Treguesin 2. Shkolla ka marrë masat përgatitore për zhvillimin e Maturës Shtetërore.

- Shkollat kanë ngritur Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore 2021, bazuar në vendimet përkatëse dhe kanë përditësuar këndin e Maturës Shtetërore për të informuar maurantët.
- Shkollat kanë informuar maurantët me kriteret e pranimit në IAL-të, dhe kanë koordinuar punën me IAL-të për njohjen e maurantëve me programet e studimit të ofruara prej tyre.
- Shkollat zhvillojnë konsultime me maurantët për lëndët e MSH 2021, bazuar në planifikimin e drejtorisë dhe sipas një orari dhe grafiku të veçantë.
- Shkollat kanë zhvilluar paratestet e provimeve të MSH 2021, sipas lëndëve dhe orarit të përcaktuar dhe miratuar nga drejtoria.

IV.5. Monitorimi dhe vlerësimi i institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar për zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe për organizimin dhe realizimin e temave përsëritëse me qëllim përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (AF), arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë (AML), si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19

Nga DPAP u zhvillua monitorim/vlerësim me tematikë “Monitorimi dhe vlerësimi i institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar për zbatimin e masave anti COVID – 19 dhe për organizimin dhe realizimin e temave përsëritëse me qëllim përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor (AF), arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë (AML), si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19” dhe për këtë tematikë u monitoruan/vlerësuan shkollat si më poshtë vijon:

1. Shkolla 9-vjeçare "Gustav Majer", Tiranë
2. Gjumnazi "Qemal Stafa", Tiranë
3. Shkolla 9-vjeçare "1 Maji", Tiranë
4. Gjumnazi "Ismail Qemali", Tiranë
5. Shkolla 9-vjeçare "Vasil Shanto", Tiranë
6. Gjumnazi "Besnik Sykja", Tiranë
7. Shkolla 9-vjeçare "1 Qershori", Tiranë
8. Gjumnazi "Arben Broci", Tiranë
9. Shkolla 9-vjeçare "Naim Frasheri", Tiranë
10. Shkolla 9-vjeçare "Jeronim De Rada", Tiranë
11. Shkolla 9-vjeçare "Ali Demi", Tiranë
12. Shkolla 9-vjeçare "Kushtrimi Lirise", Tiranë
13. Shkolla 9-vjeçare "At Zef Pllumi", Tiranë
14. Shkolla 9-vjeçare "Drita Pelinku", Tiranë
15. Shkolla 9-vjeçare "Konferenca e Pezës", Tiranë
16. Shkolla 9-vjeçare "26 Nëntori", Tiranë

Nga grupet vlerësuese për shkollat te të cilat gjatë monitorimit/vlerësimit u konstatuan problematika dhe u rekomandua (duke përcaktuar edhe afatet përkatëse):

- Drejtoritë e shkollave të marrin masa për hartimin e planeve të punës për zbatimin e Udhëzimit të MSHMS, mbi kujdesin dhe masat anti COVID-19.
- Drejtoritë e shkollave të planifikojnë lëvizjen e nxënësve në hyrje dhe dalje të IA-së, të marrin masa për distancimin fizik të nxënësve dhe të menazhojnë lëvizjet e tyre në klasa dhe korridore.
- Drejtoritë e shkollave të rifreskojnë piketimet/vijëzimet.
- Drejtoritë e shkollave të përcaktojnë mësuesin përgjegjës për matjen e temperaturës.
- Drejtoritë e shkollave të jenë në kontakt dhe të vijnë bashkëpunimin me Njësitë e Qeverisjes Vendore përkatëse për dezinfektimin e mjediseve të shkollave.
- Të hartohet plani (PEI) nga mësuesit ndihmës, në bashkëpunim me mësuesit e klasës, psikologun, prindin dhe të miratohet nga drejtoria e shkollës.
- Të hartohet plani lëndor për vijimin e mësimit plotësues dhe të miratohet nga drejtoria e shkollës.
- Të vijojë me të njëjtin përkushtim e seriozitet puna në shkollë nga drejtoria e stafi mësues, deri në përfundim të procesit të përsëritjes.
- Në të gjitha shkollat të vazhdojë dhe të rritet më tepër komunikimi me prindërit për frekuentimin e nxënësve dhe vazhdimësinë e procesit të përsëritjes.
- Mësuesit të informojnë prindërit mbi ecurinë e fëmijëve për mësimin plotësues përgjatë kësaj periudhe.

V. 6 VEPRIMTARI VLERËSUESE/INSPEKTUESE PËR VITIN 2021

DPAP-ja ka realizuar vlerësim/inspektim për vitin 2021 për:

- institucionet arsimore të arsimit parauniversitar publik;
- institucionet arsimore të arsimit parauniversitar privat;
- institucionet arsimore të arsimit parauniversitar publik/privat bazuar në ankime;
- zyrtat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP);

- drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP);

V.7. VLERËSIMI/INSPEKTIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PUBLIK:

- **Vlerësimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar.**

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim me tematikë: “Vlerësimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar” dhe për këtë tematikë u vlerësuan shkollat si më poshtë vijon:

1. Gjimnazi "Petro Nini Luarasi", Tiranë
2. Shkolla 9-vjeçare "Fan Noli", Tiranë
3. Gjimnazi "Ibrahim Rugova", Kamëz
4. Shkolla 9-vjeçare "100 Vjetori", Kamëz
5. Shkolla 9-vjeçare "Andon Xoxa", Fier
6. Shkolla 9-vjeçare "Koli Gusho", Pogradec
7. Gjimnazi "28 Nëntori", Shkodër
8. Shkolla 9-vjeçare "Ndre Mjeda", Shkodër
9. Gjimnazi "Sadik Stavaleci", Tiranë
10. Shkolla 9-vjeçare "Isa Boletini", Tiranë
11. Gjimnazi "Gramoz Palushi", Kamëz
12. Shkolla 9-vjeçare "Hillary Clinton", Kamëz
13. Shkolla 9-vjeçare "Adem Gjeli", Fushë-Krujë
14. Gjimnazi "18 Tetori", Lushnjë
15. Shkolla 9-vjeçare "Skënder Libohova", Lushnjë
16. Gjimnazi "Janaq Kilica", Fier
17. Gjimnazi "Muharrem Çollaku", Pogradec
18. Gjimnazi "Shote Galica", Fushë Krujë

Vlerësimi i institucioneve arsimore është shtrirë në të 4 DRAP-et dhe u vlerësua në drejtim të:

- Drejtuesit hartojnë planet vjetore/mujore/javore për vlerësimin e procesit mësimor dhe edukativ dhe realizojnë normën zyrtare për vlerësimin e tyre duke promovuar në mënyrë të vazhdueshme standarde të larta.
- Shkolla ka formuar klasat dhe ka shpërndarë ngarkesën mësimore në përmbushje të qëllimeve të shkollës.
- Planifikimi lëndor është bazuar në dokumentet zyrtare, si dhe në përshtatje me nevojat dhe interesat e nxënësve.
- Mësuesi harton planin ditor duke identifikuar objektin/et e të nxënësve dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësve.
- Mësuesi gjatë orës mësimore përdor metoda, teknika, si dhe strategji ndërvepruese, për një proces didaktik krijues, në përshtatje të nevojave dhe të mundësive të të gjithë nxënësve.

Në përfundim të vlerësimeve u dhanë rekomandimet për drejtoritë e shkollave:

- Drejtoritë e shkollave të përdorin instrumente vlerësimi vjetore për mësuesit bazuar në “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AF, AMU e AML”, analizat e vlerësimit të arritjeve dhe kriteret zyrtare.
- Drejtoritë e shkollave për vlerësimin e arritjeve të përdorin instrumente vlerësimi duke ju referuar vlerësimit të brendshëm të shkollës.
- Drejtoritë e shkollave të shpërndajnë ngarkesën mësimore në përputhje me udhëzuesit zyrtarë (sipas rasteve të identifikuar).
- Drejtoritë e shkollave, në bashkëpunim me ekipet lëndore të rishikojnë planet vjetore lëndore dhe të periudhës sipas formateve zyrtare bazuar në Urdhrin Nr. 31, datë. 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Drejtoritë e shkollave, në bashkëpunim me ekipet lëndore të rishikojnë planet e zhvillimit profesional, për të reflektuar mbi nevojat reale të mësuesve për trajnim.
- Mësuesit të planifikojnë veprimtari (ose detyra shtëpie) që të shfrytëzojnë teknologjinë e informacionit (kur është e mundur) dhe të përdorin më shpesh dhe më shumë mjete didaktike-mësimore për realizimin e kompetencave të nxënësit.
- Mësuesit të hartojnë situata të nxënësit reale ose të ngjashme me realitetin, të lidhura me rezultatet e nxënësit si dhe veprimtaritë konkrete për trajtimin e situatave dhe vlerësimin e realizimit të tyre.
- Mësuesit të vlerësojnë arritjet e rezultateve të nxënësit të orës mësimore si dhe të argumentojnë vlerësimin e dhënë.
- Detyrat e caktuara gjatë orës mësimore të jenë të diferencuara sipas niveleve të nxënësve duke përcaktuar kohën e realizimit të tyre në klasë.
- Mësuesit duhet të përcaktojnë kohën e realizimit të detyrave/veprimtarive në klasë, të sqarojnë kriteret e vlerësimit të tyre, si dhe të vlerësojnë nxënësit në përputhje me rezultatet e nxënësit, pra jo vetëm të njohurive, por edhe shkathtësive, qëndrimeve e vlerave të tyre.
- Drejtoritë e shkollave të analizojnë pyetësorët e zhvilluar me mësues, nxënës dhe prindër dhe të hartojnë e zbatojnë një plan pune për përmirësim (në raste të veçanta).

DPAP-ja realizoi 8 vlerësime/inspektime, të cilat u organizuan në bashkëpunim me ASCAP, DRAP, me qëllim “Monitorimi i shkollës për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar”, në 8 shkolla, me shpërndarje në të katra DRAP-et, qëllimi ishte: **Vlerësimet/inspektimet** janë kryer në shkollën:

1. “Oso Kuka”, Shkodër,
2. “ Ndre Mjeda”, Shkodër,
3. “Sevasti Qirjazi”, Korçë,
4. “Raqi Qirinxhi”, Korçë,
5. “Myslym Shima”, Tiranë,
6. “Sinan Tafaj”, Tiranë;
7. “ Luigj Gurakuqi”, Elbasan,

8. “Mahir Domi”, Elbasan.

Në përfundim të vlerësimit për institucionet arsimore u rekomandua:

Për drejtoritë e shkollave:

- të miratojnë planet lëndorë vjetorë dhe të periudhës pasi të jenë hartuar sipas formateve dhe rubrikave të përcaktuara në udhëzimet përkatëse.

Për mësuesit e shkollave,

- të planifikohen detyra të diferencuara sipas niveleve të nxënësit, në planifikimin ditor të mësuesve.
- të përcaktojnë bazën materiale që do të përdorin në orët mësimore, për realizimin e rezultateve të të nxënësve në planifikimin ditor.
- të jepen detyra shtëpie dhe klase sipas nivelit të të nxënësve.
- të zbatohen të gjitha etapat dhe të jenë të harmonizuara me njëra-tjetrën, nga rezultatet e të nxënësve deri te vlerësimi, gjatë orës mësimore.
- të vlerësojnë rregullisht detyrat e klasës/shtëpisë, duke i argumentuar ato.
- të jenë të diferencuara dhe sipas niveleve të nxënësve, detyrat e caktuara gjatë orës mësimore.
- të realizojnë strategji sa më të qarta dhe të hartojnë pyetje që nxisin diskutime për të gjitha nivelet e klasës.
- të përfshihen në mësimin online, kjo si një mënyrë për të nxitur nxënësit edhe në shtëpi, për të marrë njohuritë e duhura.
- të përdorin metoda të larmishme, që të nxisin gjithëpërfshirjen.
- të mirëmenaxhojnë klasën gjatë orës së mësimi.

➤ **Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: “Drejtimi dhe menaxhimi”.**

DPAP-ja realizoi 52 vlerësime, të cilat u organizuan në bashkëpunim me ASCAP, me qëllim “Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: “Drejtimi dhe menaxhimi”,

Inspektimi u realizua për fushën e I të vlerësimit të shkollës “Drejtimi dhe menaxhimi”, përkatësisht në:

1. Shkolla 9- vjeçare " Myredin Bashalli", Pogradec
2. Shkolla 9-vjeçare "Kajo Karafili", Pogradec
3. Shkolla 9- vjeçare "Hamdi Alinj", Pogradec
4. Shkolla 9-vjeçare "Esat dhe Muhamer Minarolli" Pogradec
5. Shkolla 9-vjeçare "Neim Muçollari", Pogradec
6. Shkolla 9-vjeçare "Sami Zgjana", Pogradec
7. SHMB "Dëshmorët e Pojskës", Pogradec
8. Shkolla 9-vjeçare "Ptoleme Xhuvani", Pogradec
9. Gjumnazi "Qemal Bazelli", Pogradec
10. SHMB "Selim Gjona", Pogradec
11. Shkolla 9-vjeçare "Shefki Muçollari", Pogradec
12. Shkolla 9-vjeçare "Gjok Shqiptari", Pogradec
13. Shkolla 9-vjeçare "Belorta", Korçë

14. Shkolla 9-vjeçare "6 Dëshmorët", Kamenicë, Korçë
15. Gjimnazi "Ymer Dishnica", Korçë
16. Shkolla 9-vjeçare "Naum Veqilharxhi", Korçë
17. Shkolla 9-vjeçare "Avdulla Asanbella", Korçë
18. Shkolla 9-vjeçare "Pandeli Care", Korçë
19. Shkolla 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë
20. Shkolla 9-vjeçare "Miraka", Librazhd
21. Shkolla 9-vjeçare "Shaban Leka", Librazhd
22. Gjimnazi "Ibrahim Muça", Librazhd
23. Shkolla 9-vjeçare "Dragostunjë", Librazhd
24. Shkolla 9-vjeçare "Sabri Qyra", Librazhd
25. Shkolla 9-vjeçare "Bogë", Kavajë
26. Shkolla 9-vjeçare "Karpen", Kavajë
27. Shkolla 9-vjeçare "Çetë", Kavajë
28. Shkolla 9-vjeçare "Shtodhër", Kavajë
29. Shkolla 9-vjeçare "Reit Bajo", Konispol
30. Gjimnazi "Sulejman Delvina", Delvinë
31. Shkolla 9-vjeçare "Adem Sheme", Sarandë
32. Shkolla 9-vjeçare "Çukë", Sarandë
33. Shkolla 9-vjeçare "Kosta Çavo", Delvinë
34. Shkolla 9-vjeçare "9 Tetori", Sarandë
35. SHMB "4 Dëshmorët", Ksamil
36. Shkolla 9-vjeçare "Mehmete Xhaferi", Xarë, Sarandë
37. Shkolla 9-vjeçare "Shefqet Sulejmani", Gjashtë, Sarandë
38. Shkolla 9-vjeçare "Bedrie Bebeiqi", Durrës
39. Shkolla 9-vjeçare "14 Nëntori", Durrës
40. Shkolla 9-vjeçare "Jusuf Puka", Durrës
41. Shkolla 9-vjeçare "Shaqe Mazreku", Durrës
42. Shkolla 9-vjeçare "Marie Logoreci", Durrës
43. Shkolla 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë", Durrës
44. Shkolla 9-vjeçare "Nënë Tereza", Durrës
45. Shkolla 9-vjeçare "Vasil Ziu", Durrës
46. Shkolla 9-vjeçare "Jashar Kola", Bulqizë
47. Shkolla 9-vjeçare "Ahmet Cami", Bulqizë
48. SHMB "Asllan Keta", Bulqizë
49. Shkolla 9-vjeçare "Elez Koçi", Bulqizë
50. Shkolla 9-vjeçare "Faslli Cami", Bulqizë
51. Shkolla 9-vjeçare "Shaban Elez Ostreni", Bulqizë
52. Shkolla 9-vjeçare "Shefqet Tançi", Bulqizë

Në përfundim të vlerësimit për institucionet arsimore u konstatua:

Shkollat zhvillohen përmes planit afatmesëm. Në shkollat e inspektuara u vu re një menaxhim në përgjithësi i mirë nga drejtuesit e institucioneve. Në përgjithësi, stafet drejtuese dhe organizmat e tjerë të ngritur në shkollë, shprehin dëshirën e mirë për punën në grup dhe kanë krijuar kushte për mirëfunksionimin e shkollave në përditshmërinë e tyre. Shkollat punojnë me plane afatmesme dhe plane vjetore, por struktura e tyre shpesh nuk ishte në përputhje me përcaktimet e Dispozitave Normative 2013, ndryshuara, (shfuqizuar) apo me nenin 49, 50, 51, 52, 53 të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr.31, datë 28.01.2020”. Për treguesin “Drejtori ka shndërruar në një kulturë të vijueshme procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës me të gjithë aktorët e shkollës, për përmirësimin e vazhdueshëm të saj” nga IA-të ka ende punë për t’u zhvilluar më tej. Për treguesin “Drejtuesit e shkollës vlerësojnë arritjet e nxënësve, të stafit dhe të ekipeve të ndryshme, duke promovuar në mënyrë të vazhdueshme standarde të larta” nga stafet drejtuese punohet, por ka ende shumë për t’u arritur, pasi jo në të gjitha institucionet përdoren instrumente vlerësues sipas standardeve referuar udhëzuesit të ASCAP për këtë proces. Për treguesin “Drejtori mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit pedagogjik, në funksion të përmirësimit të zbatimit të kurrikulës, të mësimdhënies dhe të të nxënësve të suksesshëm” në shkollë është krijuar kultura e punës për zhvillimin profesional, por jo në të gjitha IA-të departamentet lëndore kryejnë detyrën e tyre si duhet, por në raste të veçanta drejtues shkollash, që këtë proces ja lënë në dorë vetëm departamenteve dhe nuk e shohin veten të përfshirë në të.

➤ **Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit parauniversitar publik “Dhaskal Todri”, Elbasan.**

Qëllimi: Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit të arsimit parauniversitar publik “Dhaskal Todri”, Elbasan.

Në përfundim të vlerësimit për drejtorinë e gjimnazit “Dhaskal Todri”, Elbasan:

- Drejtorja e shkollës në shpërndarjen e ngarkesës mësimore duhet të zbatojë përcaktimet e udhëzimit të MASR nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Drejtorja e shkollës të shpallë pozicionin e lirë të punës në profilin TIK.
- Drejtorja e shkollës për mësuesit të cilët nuk plotësojnë kriterin e diplomës për të dhënë mësim në ciklin AML të zbatojë në fund të vitit shkollor përcaktimet e pikës 10, e vijuese të kreut 7, të udhëzimit të MASR nr.12, datë 10.06.2021.
- Të hartojnë planet vjetore/mujore/javore për vlerësimin e procesit mësimor të cilat të jenë në përputhje me dokumentat e ASCAP. “Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës” dhe “Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës”.
- Të hartojnë plane mujore dhe javore në harmoni me planifikimin vjetor.
- Të hartojnë raporte vlerësimi me rekomandime dhe sugjerime për përmirësim të cilësisë së procesit mësimor.

➤ **Vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar publik.**

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim me tematikë: “Vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar publik” dhe për këtë tematikë u vlerësuan shkollat si më poshtë vijon:

- Shkolla 9-vjeçare "Pezë", Tiranë
- Shkolla 9-vjeçare "Pezë-Helmës", Tiranë
- Gjimnazi "Myslym Shima", Tiranë
- Shkolla 9-vjeçare " Shesh", Tiranë
- Shkolla 9-vjeçare “Kasem Shima”, Mëzes Kodër

Për drejtorinë e shkollës 9-vjeçare "Shesh", Tiranë u rekomandua:

- Drejtorja e shkollës 9- vjeçare “Shesh” vartëse me Mënik, në formimin dhe ndarjen e klasave për vitin shkollor 2021-2022, duhet të zbatojë përcaktimet e udhëzimit të MASR nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Drejtori i shkollës 9- vjeçare “Shesh”, Tiranë duhet të mbajë për çdo mësues, dokumenta sipas përcaktimeve të shkronjave a, b dhe dh të pikës 1, të nenit 63, të urdhërit të MASR nr.31 datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Mësuesit në shkollën 9- vjeçare “Shesh” me vartëse Mënik, duhet të përditësojnë portofolin profesional.
- Drejtori i shkollës në fund të vitit mësimor duhet të vlerësojë stafin mësimdhënës dhe një kopje e vlerësimit duhet të mbahet në portofolin profesional të mësuesit.

Për ZVAP Tiranë:

- ZVAP Tiranë duhet të monitorojë zbatimin e udhëzimit të MASR nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, nga shkolla 9- vjeçare “Shesh” dhe vartëse Mënik.

Për DRAP Durrës:

- Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës të marrë masa konform përcaktimeve të legjislacionit në fuqi ndaj drejtorit të shkollës 9- vjeçare “Shesh”, Tiranë, për shkeljet e konstatuara në raportin e vlerësimit.

Për drejtorinë e shkollës 9-vjeçare "Pezë", Tiranë u rekomandua:

- Të hartojë vendime emërimi për mësuesit, duke përcaktuar afatin kohor jo vetëm të fillimit të marrëdhënies së punës, por edhe të mbarimit të saj.
- Protokollimi i dokumentacionit të bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- Të vlerësojë performacën e mësuesve sipas afateve të përcaktuara në pikën 4, të nenit 62, të Urdhër Nr.31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Për ZVAP Tiranë:

- Të verifikojë dhe të pranojë dokumentacion (vendim emërimi i mësuesit) ku të përcaktohet jo vetëm afati kohor i fillimit të marrëdhënies së punës, por edhe mbarimit të saj.
- Të verifikojë dhe të pranojë dokumentacion (vendime emërimi të mësuesit, kontrata individuale lidhur mes mësuesit dhe drejtuesit të IA-së), ku protokollimi i tyre të jetë sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Për drejtorinë e gjimnazit “Myslym Shima”, Yzberisht, Tiranë u rekomandua:

- Të anullojë vendimin Nr. 69/1, datë 24.04.2020 “Për shpalljen e kandidatit fitues, Z.Q. S, si kandidat fitues për pozicionin e nëndrejtorit të gjimnazit “Myslym Shima”, Yzberisht, Tiranë.
- Të shpallë vendin për nëndrejtor të gjimnazit “Myslym Shima”, Yzberisht, Tiranë, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik” dhe Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Të marrë masë disiplinore për sekretaren, Znj. E. Ç, për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Për ZVAP Tiranë:

- Të ndjekë zbatimin e anulimit të Vendimin Nr. 69/1, datë 24.04.2020 “Për shpalljen e kandidatit fitues, Z.Q.S, si kandidat fitues për pozicionin e nëndrejtorit të gjimnazit “Myslym Shima”, Yzberisht, Tiranë, dhe shpalljen e vendit për nëndrejtor të gjimnazit “Myslym Shima”, Yzberisht, Tiranë, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik” dhe Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.

Për DRAP Durrës:

- Të marrë masë disiplinore për drejtorin e gjimnazit për mosndjekjen e procedurës së emërimit të nëndrejtorit të shkollës sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”.
- Të gjitha institucionet e sipërpërmendura të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

➤ Për drejtorinë e shkollës 9-vjeçare “Pezë Helmës”, Tiranë u rekomandua:

- Të shpërndajë ngarkesën mësimore të mësuesve sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Të marrë masa që mësuesit të trajnohen çdo vit shkollor sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.1, datë 20 janar 2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
- **Për drejtorinë e shkollës 9-vjeçare “Kasem Shima”, Mëzes Kodër Tiranë u rekomandua:**
 - Të shpërndajë ngarkesën mësimore të mësuesve sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
 - Mësuesit të përditësojnë portofolet profesionale sipas përcaktimeve të Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
 - Të marrë masa që mësuesit të trajnohen çdo vit shkollor sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.1, datë 20 janar 2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
 - Të vlerësojë mësuesit bazuar në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU.
- **Vlerësimi i institucioneve arsimore për zbatimin e masave anti COVID – 19, janar 2021.**

Qëllimi: Vlerësimi i institucioneve arsimore për zbatimin e masave anti COVID – 19.

10 institucionet arsimore në varësi të ZVAP Tiranë dhe Kamëz që u vlerësuan për zbatimin e masave anti COVID–19 janë:

1. Institucioni arsimor “Hillary Clinton” Kamëz,
2. Institucioni arsimor “Kamza e Re” Kamëz,
3. Institucioni arsimor “Nënë Tereza” Kamëz,
4. Institucioni arsimor “100 Vjetori” Kamëz,
5. Institucioni arsimor “Halit Çoka” Kamëz,
6. Institucioni arsimor “Sami Frasheri” Tiranë,
7. Institucioni arsimor “Myslym Keta” Tiranë,
8. Institucioni arsimor “Besnik Sykja” Tiranë,
9. Institucioni arsimor “Qemal Stafa” Tiranë,
10. Institucioni arsimor “Partizani” Tiranë.

Në përfundim të vlerësimit për institucionet arsimore u konstatua se:

- Shkollat kanë hartuar planin për hyrjen/daljen e nxënësve, mësuesve dhe stafit mbështetës dhe ka marrë masat për të ruajtur distancimin fizik të nxënësve, mësuesve, etj, konform rregullave për masat ndaj COVID -19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore.
- Plani dhe rregullat për lëvizjet e nxënësve janë afishuar në mjediset e shkollave.

- Shkollat kanë marrë masat duke respektuar sipërfaqen për m² në dispozicion të nxënësve dhe ka vendosur tavolinat e nxënësve në largësinë e kërkuar.
- Mësuesit që zhvillojnë mësim janë të gjithë prezent në institucion dhe janë trajnuar për masat e marra dhe procedurën që do të ndiqet nga ana e tyre ndaj COVID –19 në mjediset e shkollës.
- Shkollat kanë marrë të gjitha masat e duhura për dezinfektimin dhe higjienizimin e rregullt të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të saj.
- Udhëzuesi i ASCAP për udhëzimin e fillim vitit shkollor 2020-2021 është punuar me mësuesit.
- Shkolla me vendimet përkatëse kanë vendosur për skenarin që do të zbatohet nga data 01.12.2020, dhe kanë hartuar një plan të detajuar për këtë skenar, për të cilin është marrë miratimi edhe nga Këshilli i mësuesve dhe Bordi i shkollës.
- Shkollat kanë informuar prindërit për skenarin dhe orarin e procesit mësimor nëpërmjet letrave informuese.

➤ **Vlerësimi i cilësisë së hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm dhe vjetor si dhe rregullores së brendshme të institucionit arsimor parauniversitar.**

Qëllimi: Vlerësimi i cilësisë së hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm dhe vjetor si dhe rregullores së brendshme të institucionit arsimor parauniversitar.

Institucionet arsimore në varësi të ZVAP Tiranë dhe Kamëz që u vlerësuan për cilësinë e hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm dhe vjetor si dhe rregullores së brendshme të institucionit arsimor parauniversitar janë:

1. Institucioni arsimor “Kamza e Re” Kamëz,
2. Institucioni arsimor “100 Vjetori” Kamëz,
3. Institucioni arsimor “Sami Frasheri” Tiranë,
4. Institucioni arsimor “Besnik Sykja” Tiranë,
5. Institucioni arsimor “Hillari Klinton” Kamëz,
6. Institucioni arsimor “Qemal Stafa” Tiranë,
7. Institucioni arsimor “Halit Çoka” Kamëz,
8. Institucioni arsimor “Partizani” Tiranë,
9. Institucioni arsimor “Myslym Keta” Tiranë,
10. Institucioni arsimor “Nënë Tereza” Kamëz.

Në përfundim të vlerësimit për shkollat te të cilat gjatë u konstatuan problematika, u rekomandua:

- Institucionet Arsimore, të rishikojnë dhe rihartojnë rubrikat në planin afatmesëm sipas përcaktimeve të nenit 49, 50 të Urdhërit Nr.31 datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Institucionet Arsimore të rishikojnë dhe rihartojnë rubrikat në planin vjetor sipas përcaktimeve të nenit 51, 52, 53 të Urdhërit Nr.31 datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

- Institucionet Arsimore, të rihartojnë rregulloren e brendshme të IA-së në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 02.08.2013 “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.

Për ZVAP Tiranë Kamëz:

- Të miratojë planet afatmesëm dhe vjetorë, pas verifikimit që këto plane janë hartuar konform përcaktimeve të Urdhërit nr.31 datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Të miratojë rregulloren e brendshme, pas verifikimit që rregullorja është hartuar konform përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 02.08.2013 “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.

V.8 VLERËSIMI/INSPEKTIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PRIVAT

➤ Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat “RILINDJA”, Durrës

Qëllimi i vlerësimit: Vlerësimi i zbatimit të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, VKM, Nr.99, datë 27.02.2019, “Për Krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimi Nr.15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posacme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.

Bazuar në gjetje dhe gjykime, për drejtorinë e gjimnazit privat “Rilindja”, Durrës u rekomandua:

- Të marrë masa për plotësimin e të gjithë kërkesave të parashikuara në Udhëzimin Nr.15, datë 12.07.2013 dhe të respektojë afatet ligjore.
- Të rihartojë Planin vjetor dhe Rregulloren e Brendshme në përputhje të plotë me përcaktimet e udhëzimeve përkatëse në fuqi.

➤ Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat “Çelësi Magjik”, Tiranë

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, VKM, Nr.99, datë 27.02.2019, “Për Krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimi Nr.15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posacme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat “Çelësi Magjik”, Tiranë u rekomandua:

- IA “Çelësi Magjik”, Tiranë, të zbatojë përcaktimet e Udhëzimit Nr.15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshtit “Bota e fëmijëve Elona”, Fier.**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor, për kopshtin jopublik “Bota e fëmijëve Elona”, Fier u rekomandua:

- Dënimin administrativ “Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë së kopshtit “Bota e fëmijëve Elona”, Fier.

Rekomandime për Zyrën Vendore Arsimore Fier:

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Dejor”, Fier**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “Dejor”, Fier u rekomandua:

- Të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar për rinisjen e veprimtarisë mësimore, pas mbylljes për arsye COVID -19.

Rekomandime për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Fier:

- Të kryejë verifikimin pranë institucionit arsimor privat, kopshti “Dejor”, Fier, nëse ky institucion arsimor privat është licencuar sipas akteve ligjore në fuqi.
- Të njoftojë zyrtarisht DPAP-në dhe MASR-në mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e lëna për institucionin arsimor privat “Dejor”, Fier.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Alen”, Fier.**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare jopublike, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “Alen”, Fier u rekomandua:

- Dënimin administrativ “Ndërpreje e veprimtarisë së kopshtit “Alen”, Fier.

Rekomandime për Zyrën Vendore Arsimore Fier:

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Ardi”, Fier.**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “Ardi”, Fier u rekomandua:

- Dënimin administrativ “Ndërprerje e veprimtarisë së kopshtit “Ardi”, Fier.

Rekomandime për Zyrën Vendore Arsimore Fier:

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Engjëjt e së ardhmes”, Fier**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, kopshte dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “Engjëjt e së ardhmes”, Fier u rekomandua:

- Dënimin administrativ “Ndërprerje e veprimtarisë së kopshtit jopublik “Engjëjt e së ardhmes”, Fier.

Rekomandime për Zyrën Vendore Arsimore Fier:

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Fjala e jetës”, Lushnjë.**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat dhe funksionimit të tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor, për kopshtin privat “Fjala e jetës”, Lushnjë u rekomandua:

- Referuar gjetjeve dhe konstatimeve të ushtrimit të veprimtarisë së këtij kopshti privat pa licencë, bazuar në pikën 1, të nenit 69, të ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 21, të Ligjit nr 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, grupi i punës vendos:
- Dënimin administrativ “Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë së kopshtit “Fjala e jetës”, Lushnjë.

Rekomandime për Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare Lushnjë.

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar kopshtin privat “Artistët e Vegjël 2”, Tiranë**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat dhe funksionimit të tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor, kopshtin privat “Artistët e Vegjël 2”, Tiranë:

- Dënim administrativ “Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë”.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat “ODISEA” Mallakastër**

Qëllimi: Verifikimin e dokumentacionit të institucionit arsimor privat “Odisea”, Mallakastër, vlerësimi i zbatimit të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr.15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor, shkolla e mesme jo publike “Odisea”, Mallakastër u rekomandua:

- Të dorëzojë në ZVA Mallakastër, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga shkolla e mesme jo publike “Odisea”, Mallakastër që nga viti shkollor 2007-2008 deri në përfundim të vitit shkollor 2014-2015.

Për ZVAP Mallakastër, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

- Të ngrejë grup pune dhe të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga shkolla e mesme jo publike “Odisea”, Mallakastër sipas përcaktimeve të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Të ruajë në arkivën e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas përcaktimeve të ligjit nr.9154, 2datë 06.11.2003 “Për Arkivat” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga përfaqësuesi i shkollës së mesme jo publike “Odisea”, Mallakastër.
- Të marrë të gjitha masat sipas përcaktimeve të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, për personin juridik që përfaqëson institucionin arsimor jo publik, i cili nuk zbaton rekomandimet e lëna dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.
- Të njoftojë zyrtarisht DPAP për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brënda afatit kohor të përcaktuar në VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore.

Për Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë rekomandon:

- Nga monitorimi i kryer në shkollën e mesme profesionale jo publike “Odisea”, Mallakastër, dhe në zbatim të përcaktimeve të udhëzimit të MFE nr.19 datë 01.06.2018 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të subjekteve private që kryejnë veprimtari të arsimit profesional”, DPAP duhet të inspektojë zbatimin e ligjshmërisë dhe kushteve të licensimit nga institucioni arsimor profesional jo publik “Odisea”, Mallakastër.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “ANXHES” Roskovec**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat dhe funksionimit të tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “ANXHES” Roskovec u propozua për Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

- Pezullimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar, kopshti “Anxhes”, Roskovec, licencuar me Licencë të QKL Nr. LN-0690-12-2015 me NIPT K32928407L.
- **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “4 Grykët”, Don Bosko, Tiranë**

Qëllimi: Vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti dhe funksionimit të tij, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, kopshti “4 Grykët”, Don Bosko, Tiranë u rekomandua:

- Dënimin administrativ “Ndërpreje e menjëhershme e veprimtarisë së kopshtit pranë pallateve 4 Grykët, “Don Bosko”, Tiranë”.

Për Zyrën Vendore Arsimore Tiranë:

- Të ndjekë dhe të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ekipi i vlerësimit.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, shkolla 9-vjeçare “Drita e Dijes”, Tiranë**

Qëllimi: Vlerësimi i veprimtarisë dhe zbatueshmërisë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të institucionit arsimor parauniversitar privat “Drita e Dijes”, Tiranë.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, shkolla 9-vjeçare “Drita e dijës”, Tiranë u rekomandua:

- Të sigurojë burimin alternativ për ngrohjen në shkollë.
- Të plotësojë dokumentacionin shkollor në ruajtje të përhershme (amzën), në afatet kohorë dhe në përputhje me udhëzimet që jepen në faqen e parë të saj si dhe me përcaktimet e pikës 8, të nenit 109, të Urdhrit Nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Të hartojë planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës për çdo rubrikë sipas kërkesave specifike në përputhje të plotë me udhëzuesit zyrtarë.
- Drejtoria e shkollës të miratojë planet lëndore atëherë kur ato janë në përputhje të plotë sipas udhëzuesve zyrtarë.
- Të marrë masa që mësuesit e punësuar në këtë institucion, të plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore për ushtrimin e profesionit të mësuesit.
- Të marrë masa që në klasën V të zhvillojnë procesin mësimor mësues të profilit arsim fillor.
- Të marrë masa për vijimësinë e gjuhës së huaj të parë të nxënësve të ardhur nga institucionet e tjera arsimore bazuar në dokumentin përkatës (dëftesën e klasës).
- Të evidentojë grupin e punës për hartimin e rregullores së brendshme.

Rekomandime për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Tiranë:

- Të ndjekë realizimin e rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) për institucionin arsimor privat, shkolla 9-vjeçare “Drita e Dijes”, Tiranë dhe informojë atë.

➤ **Vlerësim i institucionit arsimor parauniversitar privat, shkolla 9- vjeçare “Mësonjëtorja Dertliu”, Fier**

Qëllimi: Trajtimi dhe vlerësimi i ankesës së znj.B.G, në institucionin arsimor parauniversitar shkolla 9 – vjeçare “Mësonjëtorja Dertliu”, Fier.

Në përfundim të vlerësimit për institucionin arsimor privat, shkolla 9-vjeçare “Mësonjëtorja Dertliu”, Fier u rekomandua:

- Drejtoria e shkollës të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor privat “Mësonjëtorja Dertliu”, Fier.
- Drejtoria e shkollës të vazhdojë të vendosë ura komunikimi me mësuesit prindërit dhe nxënësit në shkollë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

V.9. VLERËSIMI/INSPEKTIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BAZUAR NË ANKIME

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, DPAP-ja ka shqyrtuar ankime, të cilat janë zgjidhur nëpërmjet vlerësimeve në terren, në shkollat e mëposhtme:

➤ **Vlerësim dhe trajtim ankese i shkollës 9-vjeçare "Mustafa Greblleshi", Tiranë**

Qëllimi i inspektimit: Verifikimi dhe trajtimi i ankesës së Znj. M.B në institucionin arsimor parauniversitar shkolla 9-vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë.

Në përfundim të vlerësimit për shkollën 9-vjeçare “Mustafa Greblleshi”, Tiranë u rekomandua:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga ZVAP Tiranë dalë nga raporti i datës 26.04.2021 me Nr.2050/1 Prot..
- Zbatimi i vendimit të organeve kolegjiale në shkollë (Komisioni i disiplinës).
- Zbatimin e procedurave ndaj mësueses Znj. M.B sipas legjislacionit në fuqi.

➤ **Vlerësim dhe trajtim ankese për SHMB “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik**

Qëllimi: Trajtimi dhe vlerësimi i ankesës së Znj. M.XH, në Institucionin Arsimor Parauniversitar Shkolla e Mesme e Bashkuar “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik.

Në përfundim të vlerësimit për SHMB “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik u rekomandua:

- Drejtoria e shkollës së mesme e bashkuar “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik, të marrë masa për rihartimin e planit afatmesëm, në përputhje me përcaktimet e neneve 49, 50, të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, si dhe të hartojë raportin vjetor në përputhje me përcaktimet e nenit 55 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Drejtoria e shkollës së mesme e bashkuar “Osman Gjini”, Mollas, Cërrik, të ndjekë procedurat për menazhimin e të ardhurave, sipas udhëzimeve në fuqi.

➤ Vlerësim dhe trajtim ankese për shkollën speciale PLM Vlorë

Qëllimi: Vlerësim dhe trajtim ankese për shkollën speciale PLM Vlorë

Në përfundim të vlerësimit për drejtorinë e shkollës speciale PLM Vlorë:

- Regjistrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollën speciale Vlorë të bëhet referuar kërkesës së prindit dhe pas rekomandimit të komisioni multidisiplinar në ZVAP Vlorë.
- Të gjithë mësuesit e shkollës të konfirmojnë në listëprezencën ditore orarin e ardhjes dhe largimit nga Institucioni Arsimor.
- Drejtori i shkollës mbi bazën e listëprezencës ditore duhet të pasqyrojë në listëprezencën mujore të gjitha mungesat e stafit mësimdhënës.
- Drejtoria e shkollës të marrë të gjitha masat për të siguruar një ambient të sigurt dhe miqësor brenda ambienteve të shkollës.
- Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me stafin pedagogjik me fillimin e vitit shkollor 2021-2022, të marrë masa për hartimin e planeve të ndërhyrjeve dhe individuale të nxënësve, me qëllim mirëqënien psiko- emocionale të tyre.
- Drejtoria e shkollës të vlerësojë procedurën e punësimit të Znj. D.D dhe të marrë masa konform përcaktimeve të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar.

Për ZVAP Vlorë:

- ZVAP Vlorë të marrë masa ndaj personit/personave përgjegjës që kanë punësuar si mësuese znj.D.D në shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar.
- ZVAP Vlorë të rakordojë me mësuesen që i janë deleguar detyrat e drejtorit, ngarkesën mësimore të gjithë stafit mësimdhënës të shkollës speciale PLM Vlorë për vitin 2021-2022 dhe nëse rezultojnë mësues pa ngarkesë mësimore, të zbatohen përcaktimet e pikës 5, e vijuese të kreut 7 të udhëzimit të MASR Nr.12, datë 10.06.2021 për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Për DPAP Tiranë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar të marrë masa për ngritjen e komisioneve “Ad Hoc” për fillimin e procedurës disiplinore ndaj personave përgjegjës në DRAP Fier të cilët:
- Me vendimin nr.12 datë 29.01.2021 kanë miratuar dorëheqje e drejtorit të shkollës speciale PLM Vlorë, duke e sistemuar më pas si mësuese brenda të njëjtës shkollë, edhe pse aty nuk ka pasur vend vakant.

➤ Vlerësim dhe trajtim ankesës për gjimnazin “Isa Boletini” Paskuqan, Kamëz

Qëllimi: Verifikimi dhe trajtimi i ankesës për mësuesen V.P në gjimnazin “Isa Boletini” Paskuqan.

Në përfundim të vlerësimit për gjimnazin “Isa Boletini”, Paskuqan u rekomandua:

- Realizimin dhe dokumentimin e orëve për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor për vitin shkollor 2020-2021, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Zbatimin e vendimit të organeve kolegjiale në shkollë (Komisioni i disiplinës).
- Zbatimin e procedurave ndaj mësueses Znj. V.P. sipas legjislacionit në fuqi.

➤ **Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit publik, të arsimit parauniversitar shkollës 9-vjeçare “Muhamet Hasmuja” Grizhë, Malësi e Madhe:**

Qëllimi: Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe dhe institucionit të arsimit parauniversitar publik “Muhamet Hasmuja” Grizhë, Malësi e Madhe.

Në përfundim të vlerësimit për shkollën 9- vjeçare “Muhamet Hasmuja” Grizhë u rekomandua:

- Drejtoria e shkollës 9- vjeçare “Muhamet Hasmuja” Grizhë në shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2021-2022 duhet të zbatojë përcaktimet e udhëzimit të MASR nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Drejtori dhe nëndrejtori i shkollës të plotësojnë normën mësimore me orë në profilin e diplomës.
- Në klasat e arsimit fillor orët e planifikuara për projektin “Bëjmë detyrat në shkollë” duhet të zhvillohen nga mësuesi i shkollës në profilin arsim fillor.
- Komisioni i vlerësimit të dosjeve në shkollë duhet të kryejë të gjitha detyrat konform përcaktimeve të udhëzimit të MASR nr. 12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe:

- ZVAP Malësi e Madhe duhet të dërgojë në DRAP Lezhë propozimin për miratim të organikës së shkollës 9- vjeçare “Muhamet Hasmuja” dhe institucioneve të tjera në varësi.
- ZVAP Malësi e Madhe, duhet të evidentojë dhe publikojë vendet vakante vetëm pas vlerësimit të ngarkesës mësimore për çdo shkollë, të cilat duhet të jenë në përputhje me numrin e klasave dhe nxënësve për klasë.
- ZVAP Malësi e Madhe duhet të informojë DPAP dhe DRAP Lezhë se si është vepruar me mësuesit të cilët ishin renditur për lëvizje paralele të detyrueshme por që nuk i janë përgjigjur ftesës për një vend punë në IA.

Rekomandime për Masa Disiplinore:

Për DPAP Tiranë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar të marrë masa për ngritjen e komisioneve “Ad Hoc” për fillimin e procedurës disiplinore ndaj drejtorit të ZVAP Malësi e Madhe, për shkeljet e konstatuara në raportin e monitorimit.

Për DRAP Lezhë:

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë të fillojë procedurën disiplinore ndaj drejtorit të shkollës “Muhamet Hasmuja”, Grizhë për shkeljet e konstatuara në raportin e monitorimit.
- **Vlerësimi i veprimtarisë së institucionit publik, të arsimit parauniversitar SHMB “Mihal Nako”, Fier-Seman, Divjakë:**

Qëllimi: Trajtimi dhe vlerësim ankese së Z. RV.

Në përfundim të vlerësimit për SHMB “Mihal Nako”, Fier-Seman, Divjakë u rekomandua:

Për Drejtorinë e SHMB “Mihal Nako”, Fier-Seman, Divjakë

- Mësuesi ndihmës që punon me nxënësin e klasës së X^{-të}, duhet të hartojë planin PEI duke marrë si referencë planin mësimor dhe programet lëndore të klasës së X, për ta përshtatur, me synim nivelin bazë të arritjeve.
- Drejtoria e shkollës në përfundim të vitit mësimor 2021-2022 të ndjekë procedurat e identifikimit të vëndeve të punës për mësues ndihmës, konform përcaktimeve të kreut 5, të urdhërimit të MASR nr. 12 datë 10.06.2021 Për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë, i ndryshuar.
- Komisioni i etikës dhe sjelljes dhe komisioni i disiplinës në shkollë duhet të ngrihen referuar bazës ligjore në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar.
- Drejtoria e shkollës të anullopë procedurën e iniciuar dhe masën disiplinore të dhënë ndaj mësuesit Z.R.B dhe të rifillojë këtë procedurë konform përcaktimeve të nenit 39, 101 dhe 107 të urdhërimit të MASR nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Drejtoria e shkollës në shpërndarjen e ngarkesës mësimore duhet të zbatojë përcaktimet e udhërimit të MASR nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Drejtoria e shkollës të shpërndajë ngarkesën mësimore të mësuesve të profilit Marematikë, Fizikë, Histori dhe Gjeografi, konform përcaktimeve të udhërimit të MASR nr.30 datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Drejtoria e shkollës për ato profile/lëndë që bie ngarkesa mësimore, të zbatojë përcaktimet e pikës 10, 11 dhe 5, të udhërimit të MASR nr. 12, datë 10.06.2021 Për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë, i ndryshuar.
- Për të gjithë mësuesit që do të rezultojnë pa ngarkesë mësimore ose ngelën të pasisteluar për arsye të mungesës së vëndeve të punës të zbatohen përcaktimet e pikës 12, të kreut 7 të urdhërimit të MASR nr. 12, datë 10.06.2021 Për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë, i ndryshuar.
- Për zbatimin e rekomandimeve të lëna drejtoria e shkollës duhet të njoftojë ZVAP Divjakë.

Për ZVAP Divjakë

- ZVAP DIVJAKË në emërimin e mësuesve ndihmës në shkolla duhet të zbatojë përcaktimet e pikës 7, të kreut 8, të shkronjës a dhe b, të pikës 3, të kreut 9, si dhe përcaktimeve të Udhëzimit të MASR, Nr.26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

V.10. VLERËSIMI/INSPEKTIMI I ZYRAVE VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ZVAP)**➤ Vlerësimi i ZVAP për procedurat e ndjekura për Kualifikimin e mësuesve 2021**

Janë vlerësuar këto ZVAP: ZVAP Cërrik, ZVAP Vorë, ZVAP Rrogozhinë, ZVAP Krujë, ZVAP Shijak. Nga inspektimet u konstatua se ZVAP-të kanë marrë masat për zbatimin e udhëzimit mbi kualifikimin e mësuesve, disponojnë dokumentacionin mbi plotësimin e kriterëve të pranimit për të qenë kandidat për kualifikimin 2021, konform udhëzimit për këtë proces.

Në përfundim të vlerësimit në ZVAP-të u konstatua se:

- ZVAP-të ka informuar kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit, paraqitjen e kërkesës për kualifikim si dhe portofolin profesional të kandidatit, të cilat i ka shqyrtuar dhe miratuar ato.
- ZVAP-të kanë organizuar seanca informuese me kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit dhe kanë ngritur grupin e përgjegjës për kualifikimet për vitin 2021.
- ZVAP-të ka njoftuar me email çdo kandidat për rezultatet e vlerësimit të portofolit.
- ZVAP-të kanë trajtuar ankesat (aty ku kishte) drejtuar ZVAP-së, për të cilat ka dhënë sqarimet përkatëse bazuar në ligjet në fuqi.
- ZVAP-të kanë verifikuar kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret e vjetërsisë së punës në arsim, bazuar në kategorinë për të cilën ata do të kualifikohen dhe janë plotësuar formularët e aplikimit të kandidatit.
- ZVAP-të kanë verifikuar kreditet e fituara nga kandidatët, të cilët zotërojnë certifikatat me kreditet e nevojshme sipas kategorisë që do të kualifikohen.
- ZVAP-të kanë ngritur komisionet për vlerësimin e portofolit të kandidatëve në kualifikimin e mësuesve sipas profileve përkatëse.
- Vlerësimi i kandidatëve nga grupet vlerësuese ngritur pranë ZVAP-ve në përgjithësi është kryer sipas rubrikave (shtojcape) konform udhëzimeve përkatëse.
- ZVAP-të zotërojnë procesverbalet e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për çdo komision dhe janë nëshkruar nga grupet vlerësuese.
- ZVAP-të kanë hartuar databazën me listën përfundimtare dhe pikët përkatëse për çdo kandidat dhe e ka dërguar në DRAP, sipas databazës së përcaktuar nga ASCAP.

➤ Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Pukë

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim me tematikë: “Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik”.

Në përfundim të vlerësimit për ZVAP Pukë u rekomandua:

- Të realizohet ndarja e klasave bazuar në numrin e nxënësve në përputhje të plotë me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Stafi drejtues dhe mësimdhënës të zhvillojë lëndë sipas profilit kryesor dhe të përafërt sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Të miratojë ngarkesën mësimore të IAP-ve në varësi të saj, në përputhje të plotë me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Të vijojë zbatimin e Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021, Për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë për shpalljen e vendeve të lira, kryerjes së procedurave të Lëvizjes Paralele dhe punësimet e kandidatëve sipas renditjes të Portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe dokumentimit të vendit të punës.
- Të zbatohet me përpikmëri, Kreu 9, i Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021, “Punësimin në raste të veçanta”, garanci ligjore për punësimet jashtë listave të portalit dhe në funksion të rritjes së transparencës së tyre.

Për DRAP Lezhë:

- Të miratojë ngarkesën mësimore të IAP-ve në varësi të ZVAP Pukë-Fushë Arrëz në përputhje të plotë me përcaktimet e Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.

➤ Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Has

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim/inspektim me tematikë: “Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik”.

Në përfundim të vlerësimit për ZVAP Has u rekomandua:

- ZVAP Has të monitorojë procesin e formimit dhe ndarjes së klasave në institucionet arsimore në varësi, konform përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- ZVAP Has dhe institucionet arsimore të identifikojnë pozicionet e lira të punës duke specifikuar vendet vakante dhe ato me afat kohor të përcaktuar.
- Për të gjitha punësimet në raste të veçanta, ZVAP Has duhet të zbatojë përcaktimet e pikës 1,2 dhe 3 të kreut 9 të udhëzimit të MASR nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

➤ Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim me tematikë: “Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik”.

Në përfundim të vlerësimit për ZVAP Bulqizë u rekomandua:

- ZVAP Bulqizë, të ndajë ngarkesën mësimore dhe sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- ZVAP Bulqizë, të zbatojë me korrektësi përcaktimet e Udhëzimit të MASR Nr. 12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- ZVAP Bulqizë të zbatojë me korrektësi përcaktimet e Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.
- DRAP Durrës dhe ZVAP Bulqizë të miratojnë organikat e institucioneve të arsimit parauniversitar publik, sipas përcaktimeve të pikës 7, të VKM Nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

➤ Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kukës

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësim me tematikë: “Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve të arsimit parauniversitar publik”.

Në përfundim të vlerësimit për ZVAP Kukës u rekomandua:

- Të marrë masa që për të gjitha rastet e konstatuara nga ekipi i vlerësimit ku punonjësit e shërbimit psiko-social nuk plotësojnë kriteret përkatëse, të shpallë vendet vakante dhe t'i kërkojë DRAP Lezhë zhvillimin e procedurave të konkursit për pozicionin e punonjësve të shërbimit psiko-social sipas përcaktimeve të Urdhrit Nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, për shërbimin psiko-social.
- ZVAP Kukës dhe Institucionet Arsimore Publike në varësi të saj, të marrin masa për ndarjen e klasave sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Mësuesit ndihmës të përzgjidhen dhe të punësohen sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MASR-së Nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” si dhe në vijim të Udhëzimit Nr.12, datë 12.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- Komisioni i vlerësimit të dosjeve të dokumentojë me korrektësi të gjitha emërimet për lëvizjet paralele (me dëshirë dhe detyrim) sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 12.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet

arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

- ZVAP Kukës dhe institucionet arsimore publike në varësi të saj, të dokumentojnë çdo procedurë për pranimin dhe emërimin e mësuesit konform përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 12.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Rekomandime për DRAP Lezhë:

- DRAP Lezhë si autoriteti përgjegjës, për të gjitha rastet e konstatuara nga ekipi i vlerësimit ku punonjësit e shërbimit psiko-social nuk plotësojnë kriteret përkatëse, të marrë masa për zhvillimin e procedurave të konkursit për pozicionin e punonjësve të shërbimit psiko-social sipas përcaktimeve të Urdhrit Nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, për shërbimin psiko-social.
- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë, si autoriteti përgjegjës, të marrë masa për verifikimin dhe miratimin e ngarkesës mësimore dhe numrin e punonjësve në shkollat në juridiksion të Zyrës Vendore Arsimore Kukës, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi.

Rekomandime për DPAP:

- DPAP të hapë procedurat e konkurimit për specialist të sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Kukës, për plotësim të shërbimit pranë kësaj ZVAP-je.

Propozime për masa:

- Bazuar në urdhërin e MASR-së Nr. 454 datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, për Specialistin e Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit profesional, znj. Flora Oka si anëtare e KVD 2019 propozojmë dalje para “komisionit Ad hoc”, për moszbatimin e detyrave, mosmonitorimin dhe mos dokumentimin e zbatimit të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin Nr.13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.
- Bazuar në urdhërin e MASR-së Nr.454 datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, për ish drejtorin e ZVAP Kukës z.Skënder Ahmeti (duke qenë se është larguar nga kjo detyrë), propozojmë dalje para “Komisionit Ad hoc” për moszbatim të përcaktimeve Udhëzimit Nr.13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” i ndryshuar, gjatë procedurave të lëvizjeve paralele, si dhe për procedurat e emërimit të mësuesve ndihmës pa kaluar në procedurat e lëvizjes paralele, realizimin e lëvizjes së 2 mësuesve bazuar në kërkesa individuale të mësuesve dhe drejtuesve të IA-së dhe jo nëpërmjet lëvizjes paralele me dëshirë si dhe për mos zhvillimin e procedurave të konkurimit të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe emërimin e tri punonjësve të SHPS që nuk plotësojnë kriteret e arsimimit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bazuar në urdhërin e MASR-së Nr.454 datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurimit për pranimin dhe lirim nga detyra të nëpunësve të

DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, për juristen e ZVAP Kukës, znj. Edlira Bytyçi propozojmë dalje para “komisionit Ad hoc”, për moszbatim të detyrave dhe mos dokumentimin e zbatimit të procedurave të përcaktuara sipas Udhëzimit Nr.13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar” i ndryshuar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, gjatë procedurave të lëvizjeve paralele, si dhe për procedurat e emërimit të mësuesve ndihmës në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimeve në fuqi.

Për MASR, propozojmë:

- Audit të brendshëm për ZVAP Kukës.

Nga ndarja e klasave në institucionet arsimore në varësi të ZVAP-së Kukës janë rreth 6 mësues tepër në sistem për vitin shkollor 2019-2020, dhe 16 mësues tepër për vitin shkollor 2020-2021, në shkelje të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”. Kjo ka ardhur si rezultat i dhënies nga IA numër klasash tepër gjatë parashikimit të numrit të nxënësve për klasë, të cilat janë aprovuar nga ZVAP-ja Kukës dhe mbi këtë parashikim MASR ka aprovuar fondin e pagave. Në realitet, numri faktik i klasave duhet të ishte më pak se numri i deklaruar nga ZVAP-ja. Kjo për pasojë sjell numër mësuesish tepër dhe si rrjedhojë tejkalim të fondit real të pagave. Mbi bazë të këtyre të dhënave konstatuar nga verifikimi mbi deklarinimin zyrtar të të dhënave si nga IA dhe ZVAP-ja Kukës *propozojmë audit të brendshëm* nga strukturat përkatëse për ZVAP Kukës.

Rekomandime për DRAP Lezhë:

Mbështetur në Urdhrin Nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 106, pika 2/a të marrë masa disiplinore për drejtuesit e institucioneve arsimore:

- Për drejtuesit e institucioneve arsimore si më poshtë vijon:

“Havzi Nela”, “Lidhja e Prizrenit”, “1 Qershori”, SHMB “Qazim Shehu”, SHMB “9 Shtatori”, “Vehbi Shehu”, “Elmaz Ademi”, për shkelje të përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, duke formuar klasa më tepër jo të bazuar në numrin e nxënësve nxënësve dhe si rrjedhojë ka mësues më tepër në këto institucione arsimore.

- Për drejtuesit e institucioneve arsimore si më poshtë vijon:

SHMB “Bushtricë”, “Orçikël”, “Sahit Gega”, SHMB “Shishtavec”, “Përbreg”, “Bajram Curri”, “Lidhja e Prizrenit”, “Mersin Bresa”, “Malqenë”, “Ahmet Voka”, “1 Qershori”, “Avni Rustemi”, SHMB “Shemri”, “Remzi Xhaferraj”, Riza Spahiu”, “Qazim Shehu”, “Beqir Hamza”, “Gani Duraku”, për shkelje në emërimin e mësuesve ndihmës, të cilët janë emëruar jo nëpërmjet lëvizjes paralele, mësues të emëruar pa “Portalin Mësues për Shqipërinë”, si dhe për lidhje të kontratave me afate 3 mujore, të cilat janë realizuar në shkelje të përcaktimeve të pikës 9, të Kreut 4, të Udhëzimit Nr.13, datë 22.05.2019 Për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një

vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

➤ **Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan**

Qëllimi: Procedura që ka ndjekur ZVAP Elbasan për parashikimin e ngarkesës mësimore dhe emërimin e mësuesve për gjimnazin “Dhaskal Todri”, Elbasan.

Në përfundim të vlerësimit për ZVAP Elbasan u rekomandua:

- ZVAP Elbasan të rakordojë ngarkesën mësimore për çdo IA në bashkëpunim me drejtorët e IA në varësi.
- ZVAP Elbasan të verifikojë diplomat e punonjësve arsimorë dhe përputhshmërinë e vendit të punës për çdo IAP në varësi.
- ZVAP Elbasan të plotësojë protokollin e institucionit konform përcaktimeve të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- Kërkesat e punonjësve arsimor për dorëheqje nga pozicioni i punës duhet të administrohen nga IA dhe jo nga ZVAP.

➤ **Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Cërrik**

Qëllimi: Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Cërrik.

Në përfundim të vlerësimit në ZVAP Cërrik u rekomandua:

- Të ndjekë dhe zbatojë procedurat për formimin e klasave dhe shpërndarjen e ngarkesave mësimore të IA-ve në përmbushje të qëllimeve të IA-ve, në përputhje me udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Të ndjekë procedurat për emërimin e mësuesve ndihmës, në përputhje me përcaktimet e udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021, për “Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- Të zbatojë procedurat e protokollimit të dokumentacionit, bazuar në ligjet/udhëzimet për arkivat në fuqi.
- Të miratojë planet afatmesme dhe vjetore të IA-ve, sipas përcaktimeve të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe të zotërojë të gjitha planet afatmesme dhe vjetore (kopje nga origjinali) të IA-ve në varësi të saj.

Propozim Komisionit Ad-Hoc:

Propozim për masë disiplinore për komisionin e ngritur për menazhimin e portalit “ Mësues për Shqipërinë” për vitin shkollor 2021-2022, në ZVAP-Cërrik, me përbërje si më poshtë:

- M. M, (kryetare)

- A. V (anëtare)
- A Sh (anëtar)

për moszbatim të procedurave të emërimit të mësuesve ndihmës, sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 10.06.2021 për “Procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimi e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, si dhe moszbatim të procedurave të protokollimit të dokumentacionit, bazuar në ligjet/udhëzimet për arkivat në fuqi.

➤ **Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe**

Qëllimi: Vlerësimi i veprimtarisë së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Malësi e Madhe dhe institucionit të arsimit parauniversitar publik “Muhamet Hasmuja” Grizhë, Malësi e Madhe.

Në përfundim të vlerësimit në ZVAP Malësi e Madhe u rekomandua:

- ZVAP Malësi e Madhe duhet të dërgojë në DRAP Lezhë propozimin për miratim të organikës së shkollës 9- vjeçare “Muhamet Hasmuja” dhe institucioneve të tjera në varësi.
- ZVAP Malësi e Madhe, duhet të evidentojë dhe publikojë vendet vakante vetëm pas vlerësimit të ngarkesës mësimore për çdo shkollë, të cilat duhet të jenë në përputhje me numrin e klasave dhe nxënësve për klasë.
- ZVAP Malësi e Madhe duhet të informojë DPAP dhe DRAP Lezhë se si është vepruar me mësuesit të cilët ishin renditur për lëvizje paralele të detyrueshme por që nuk i janë përgjigjur ftesës për një vend punë në IA.

Rekomandime për Masa Disiplinore:

Për DPAP Tiranë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar të marrë masa për ngritjen e komisioneve “Ad Hoc” për fillimin e procedurës disiplinore ndaj drejtorit të ZVAP Malësi e Madhe, për shkeljetekonstatuaranëraportinemonitorimit.

Për DRAP Lezhë:

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë të fillojë procedurën disiplinore ndaj drejtorit të shkollës “Muhamet Hasmuja”, Grizhë për shkeljet e konstatuara në raportin e monitorimit.

V.11 VLERËSIMI/INSPEKTIMI I DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (DRAP):

- **Vlerësimi i DRAP Korçë, DRAP Fier, DRAP Durrës dhe DRAP Lezhë për procedurën e ndjekur për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në Portalin Mësues për Shqipërinë 2021.**

Nga DPAP-ja u zhvillua vlerësimi i DRAP Durrës, DRAP Fier, DRAP Lezhë dhe DRAP Korçë me tematikë: “Vlerësimi i DRAP-ve për procedurën e ndjekur për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve në Portalin Mësues për Shqipërinë 2021”.

Në përfundim të vlerësimit për institucionet arsimore u rekomandua:

Për DRAP Korçë:

- DRAP Korçë të protokollojë ankesat dhe kthim përgjigjet e aplikantëve të portalit “Mësues për Shqipërinë” në zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- DRAP Korçë të aktivizojë më shumë sekretarë teknikë për të eliminuar gabimet gjatë procesit të vlerësimit të dosjeve të aplikantëve, si dhe vlerësim korrekt brenda afateve.
- DRAP Korçë të konfirmojë brenda afateve vlerësimin e aplikantëve sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit Mësues për Shqipërinë”.
- DRAP Korçë të vijojë me zbatimin e procedurave të përcaktuara në pikën 10, 11, 12 të kreut 1, si dhe detyrat specifike të përcaktuara në kreun 7, 8 dhe 9 të udhëzimit të MASR Nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit Mësues për Shqipërinë”.

Për DRAP Fier :

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, të vijojë me zbatimin e procedurave të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të Kreut 1, si dhe detyrat specifike të përcaktuara në Kreun 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Për DRAP Durrës:

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar të analizojë punën e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD), anëtarëve të sekretarisë teknike, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas përcaktimeve të urdhrit Nr.454, datë 13.09.2019 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e pranimit dhe lirimit nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj konkretisht:

- Për moszbatim të përcaktimeve të Udhëzimit Nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Për DRAP Lezhë :

- DRAP Lezhë të vijojë me zbatimin e procedurave të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të kreut 1, si dhe detyrat specifike të përcaktuara në kreun 7, 8 dhe 9 të udhëzimit të MASR Nr. 12 datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit Mësues për Shqipërinë”.

V.12 ANKIME

Ankime të ardhura për shkollat dhe ZVAP-të gjatë vitit 2021

DPAP-ja për vitin 2021 ka trajtuar 150 ankimime, të cilat i ka shqyrtuar të gjitha nëpërmjet komunikimit zyrtar, me email, apo verifikim në subjekt (vlerësim), në bashkëpunim me ZVAP-të. DPAP-ja ka shqyrtuar ankesat e drejtuara në kryeministri, MASR dhe DPAP. Objekti kryesor i ankimeve ka qenë verifikimi i problematikave ngritur nga ankimuesit:

- Vlerësimi i dosjes së mësuesve nga drejtuesit e IA për procedurat e lëvizjes paralele me detyrim,
- Menazhimi i burimeve njerëzore,
- Procedurat e emërimit të mësuesve ndihmës nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”,
- Procedurat e emërimit të mësuesve nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”,
- Procedurat për emërimin e drejtorëve,
- Procedurat për emërimin e shërbimit psiko-social etj.

VI. ASPEKTE JURIDIKE

Për vitin 2021 janë gjithsej 6 çështje gjyqësore, nga të cilat: 1 është në proces gjyqësor; 1 është fituar nga DPAP; 3 është përjashtuar nga procesi gjyqësor; 1 ka ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë, pasi gjykata ka pranuar kërkesë padinë e paraqitur nga pala paditëse.

- **3 Masa disiplinore të dhëna**

1. B.N. – Masa “Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënieve të punës”.
2. E. Gj. – Masa “Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënieve të punës”.
3. V.K. – Masa “Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënieve të punës”.

- **15 Njoftime për fillimin e procedurës disiplinore**

1. F. O.
2. S. A.
3. B.G.
4. B.S.
5. E. S.
6. M. B.
7. K. Y.
8. 8 drejtues ZVAP Tiranë, Dibër, Bulqizë, Mat, Kavajë, Durrës dhe Shijak

- **5 procese gjyqësore nga të cilat:**

- **Të përfunduara:**

1. D. L., DPAP është përjashtuar nga procesi gjyqësor.
2. S. T., DPAP është përjashtuar nga procesi gjyqësor.
3. F. Ç., DPAP është përjashtuar nga procesi gjyqësor.

4. K. Sh., DPAP ka ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë, pasi gjykata ka pranuar kërkesë padinë e paraqitur nga Kozeta Shehaj.
5. E. R., rrëzuar kërkesa e palës paditëse.
6. B.N., në proces
 - Për vitin 2021 janë dhënë 3 (tre) masa disiplinore, “Zgjidhje e menjëherëshme e marrëdhënieve të punës” për Drejtor dhe punonjës ZVAP-ve.
 - Për vitin 2021 kanë filluar procedurat disiplinore edhe për 15 (pesëmbëdhjetë) Drejtor dhe punonjës ZVAP-je dhe janë në fazën e vlerësimit nga komisionet Ad-Hoc.
 - Asistencë juridike i është ofruar në mënyrë të vazhdueshme 52 ZVAP-ve dhe 4 DRAP-ve për: proceset gjyqësore; udhëzimet e dala nga MAS; problematika të ndryshme të hasura gjatë punës së tyre të përditshme; ankesa të ndryshme etj.
 - Nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, në rolin e Autoritetit Kontraktor, janë zhvilluar gjithsej 5 (pesë) procedura prokurimi, të cilat kanë përfunduar me lidhjen e kontratës, si më poshtë, me fond limit pa TVSH;
 - ☞ Blerje kancelarie, me fond limit 83.333 lekë
 - ☞ Blerje materiale pastrimi, me fond limit 58.333 lekë
 - ☞ Blerje Tонера, me fond limit 83.333 lekë
 - ☞ Shërbime siguracioni TPL për automjetin në pronësi të DPAP, me fond limit 50.000 lekë
 - ☞ Blerje Karburanti, me fond limit 416.667 lekë
 - Përgatitja e urdhreve të ndryshëm dhe përgatitja e shkresave për institucionin e DPAP-së.
 - Trajtimi i ankesave të ardhura në DPAP nga qytetarët apo platforma e bashkëqeverisjes.

VII. ASPEKTE FINANCIARE, SHËRBIME, SHPENZIME

- Shtator 2021, në rakordim me ZVAP-të dhe MASR-në, është realizuar rishpërndarja e planit të numrit të punonjësve mësimorë sipas kërkesave të ZVAP-ve: Arsimi bazë 23655 punonjës mësimorë; AML 6485 punonjës mësimorë.
- Në bazë të rakordimit dhe kërkesave të ZVAP-ve është bërë shpërndarja e numrit të praktikantëve që do të kryejnë praktikën mësimore për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, gjithsej 2300 praktikantë.
- Në mbështetje të urdhrit të Ministrit të MASR nr.313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, në bazë të rakordimit dhe kërkesave të ZVAP-ve është bërë përlogaritja e ndryshimit të numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar.
- Në vitin shkollor 2019-2020 kishim 342 punonjës të shërbimit psiko-social.
- Në vitin shkollor 2020-2021 kemi gjithsej 592 punonjës të shërbimit psiko-social.
- Shpërndarja e 1000 mësuesve me kontratë të përkohshme që do të zëvendësojnë mësuesit me raport mjekësor nga COVID-19 për vitin shkollor 2020-2021, në bazë të VKM 769, datë 30.09.2020.

- Subvencioni i teksteve për vitin 2021-2022:

Për vitin 2021-2022 janë mbështetur me fonde të buxhetit të shtetit 259973 nxënës në arsimin parauniversitar sipas tabelës më poshtë:

DRAP	Nxënës përfutur libra fals klasa I	Nxënës përfutur libra fals klasa II	Nxënës përfutur libra fals klasa III	Nxënës përfutur libra fals klasa IV	Nxënës përfutur libra fals klasa V	Nxënës përfutur libra fals klasa VI	Nxënës përfutur libra fals klasa VII	Nxënës përfutur libra fals klasa VIII	Nxënës përfutur libra fals klasa IX	Nxënës përfutur libra fals klasa X	Nxënës përfutur libra fals klasa XI	Nxënës përfutur libra fals klasa XII	Total klasa I- XII
Durrës	12477	12836	12715	13233	12574	12147	12504	12526	13046	1571	1442	1322	118393
Fier	4499	4287	4390	4891	4615	4361	4566	4883	4871	521	534	459	42877
Lezhë	3951	3945	4064	4222	3913	3927	3640	4287	4403	1442	1349	1321	40464
Korçë	5426	5568	5765	5985	5997	5942	5910	6170	6012	1849	1781	1834	58239
Gjithsej	26353	26636	26934	28331	27099	26377	26620	27866	28332	5383	5106	4936	259973

Për të gjitha kategoritë që kanë përfutur tekstet fals 1,090,993,531 lekë ka qenë fondi për mbulimin e subvencionit të teksteve shkollorë. Të dhënat për secilin DRAP i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

DRAP	FONDI I KËRKUAR AMU KLASA I-IX (09120)	FONDI I KËRKUAR AML KLASA X-XII (09230)	FONDI I KËRKUAR AMU+ AML KLASA I- XII
Durrës	447,382,303	33,971,024	481,353,327
Fier	163,244,269	10,773,350	174,017,619
Lezhë	151,365,276	33,220,942	184,586,218
Korçë	207,935,872	43,100,495	251,036,367
Gjithsej	969, 927, 720	121, 065, 811	1,090,993,531



- Buxheti i miratuar për 2021 bashkë me ndryshimet gjatë vitit 2021:

KODI	GR	PROG	KAP	PROJEKTI	ART	PLAN	REALIZIMI	
							Në Lekë	Në %
1011265	11	1110	1	91101AE	600	18,040,000	17,521,130	97.12
1011265	11	1110	1	91101AE	601	3,45,880	2,903,309	95.32
1011265	11	1110	1	91101AE	602	1,000,000	999,510	99.95
1011265	11	1110	1	91101AA	602	1,464,000	1,458,971	99.66
1011265	11	1110	1	91101AE	606	147,000	147,000	100.00
TOTALI						23 696 880	23,029,920	97.19

- Për vitin 2021 janë kryer:

Nr	Shpenzime sipas zërave me vlerë TVSH	Vlera në lekë
1	Likujdimi i pagave për punonjësit e DPAP	17,521,130 lekë
2	Likujdimi i sigurimeve shoqërore për punonjësit e DPAP	2,903,309 lekë
3	Likujdimi i faturave për shpenzime operative	612,857 lekë.
4	Karburant	448,074 lekë
5	Kancelari	99,562 lekë
6	Tonera	99,000 lekë
7	Materiale për pastrim dhe dezinfektim	68,256 lekë
8	Program kompjuterik për funksionimin e programit të transparencës	86,400 lekë
9	Taksa vendore, Sigurime etj	66,892 lekë
10	Shpenzimet për udhëtime/inspektime të punonjësve	977,440 lekë
11	Shpenzime për shpërblym për punonjësit në pension	147,000 lekë

Shpenzimet në lekë për vitin 2021




- Janë përgatitur pasqyrat e projektbuxhetit afatmesëm 2022-2024.

- Janë përgatitur pasqyrat financiare për vitin 2020, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave
- Çdo 4-mujor është kryer raportimi i monitorimit financiar për DPAP –në, në bazë të ligjit 10296/008.07.2020 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Çdo 3-mujor, edhe sipas kërkesave të MASR-së, është kryer raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura, ku për DPAP-në nuk kemi pagur detyrime të tilla.
- Në bazë të rakordimit me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar është bërë verifikimi i ndarjes së klasave dhe numrit të nxënësve për klasë, në mbështetje të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” dhe Udhëzimit Nr.14, datë 28.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” të ndryshuar”. Në krahasim me vitin e kaluar është respektuar numri i nxënësve për klasë dhe ndarja e klasave në bazë të udhëzimit. Mbeten problem zonat e thella malore ku numri i nxënësve është në rënie dhe ekzistojnë akoma klasat e arsimit të mesëm të lartë me numër të vogël nxënësish (*më pak se 10 nxënës*), gjithashtu kemi dhe klasa në AMU *me një nxënës*.
- Në bazë të planifikimit të mësimi me turne, sipas skenarëve të përcaktuar për vitin shkollor 2020-2021, për shkak të situatës së krijuar nga COVID -19, kemi orientuar Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar për mënyrën e llogaritjes së orëve suplementare që u takojnë mësuesve sipas ngarkesës mësimore dhe është bërë përmbledhësja e efekteve financiare që rrjedhin nga pagesa e këtyre orëve 81 587 000 lekë në muaj.
- Në Qershor 2021 janë shpërndarë 1000 pajisje elektronike për mësuesit që japin mësim në klasat kolektive dhuratë nga “Unicef Albania”.
- Me mbështetjen e partnerëve tanë zhvillimorë UNICEF, Eorl Vision, Save dhe Children, Confindustria etj., përveç ndihmave në mjete të teknologjisë, janë furnizuar institucionet arsimore me maska mbrojtëse, termometra dhe dezinfektantë për nxënësit dhe mësuesit.

VIII. PERFORMANCA E PUNONJËSVE NË DPAP DHE INSTITUCIONET E VARËSISË:

Performanca e punonjësve aktualë			
DRAP Durrës	DRAP Fier	DRAP Korçë	DRAP Lezhë
- 123 punonjës - 67 shumë mirë - 53 mirë - 1 Mjaftueshëm - 2 nuk janë vlerësuar pasi janë me leje lindje	- 105 punonjës - 50 shumë mirë, - 49 mirë - 1 mjaftueshëm - 5 punonjës të rinj të cilët nuk janë vlerësuar ende	- 124 punonjës - 64 shumë mirë, - 57 mirë - 1 Mjaftueshëm. - 2 punonjës të rinj të cilët nuk janë vlerësuar ende	- 91 punonjës - 71 shumë mirë, - 17 mirë - 3 dobët.

Janë vlerësuar 434 punonjës gjithsej, nga të cilët: 252 shumë mirë, 176 mirë, 3 mjaftueshëm dhe 3 dobët.



IX. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka marrë pjesë aktive në përgatitjen udhëzimeve të ndryshme duke dhënë mendime dhe sygjerime për ndryshime të udhëzimeve, si më poshtë vijon:

- Për ndryshimin dhe përmirësimin e udhëzimit Nr.12, datë 10.06.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” për arsye të rregullimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit mësimor që janë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës për drejtuesit të cilën japin dorëheqje nga ky pozicion.
- Ka marrë pjesë dhe dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e Udhëzimit Nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” për arsye të rregullimit të procedurave të emërimit të drejtorit për arsye të hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore.
- Ka marrë pjesë dhe ka kërkuar ndryshimin e Udhëzimit Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik” për arsye të ndryshimit të kuadrit ligjor në fushën e arsimit dhe përshtatjen me këto ndryshime.
- Ka marrë pjesë dhe dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e VKM Nr. 682 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, për arsye të rregullimit për të caktuar Autoritetin Kontraktor që do të zhvillojë procedurat e prokurimit të transportit.
- Ka marrë pjesë dhe ka dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e Udhëzimit Nr. 46, datë 16.03.2021 “Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022”, për arsye të ndryshimit të bazës ligjore të sistemit tatimor në lidhje me faturat e fiskalizuar.
- Ka marrë pjesë dhe ka dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhërin e MASR-së Nr.31, datë 28.01.2020.
- Ka marrë pjesë dhe ka dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, për uljen e numrit të nxënësve për klasë dhe uljen e ngarkesës mësimore.
- Ka marrë pjesë dhe ka dërguar mendime për ndryshimin dhe përmirësimin e Rregullores për Maturën Shtetërore për të realizuar një proces sa më transparent dhe për të përcaktuar sa më saktë detyrat dhe përgjegjësisë për të gjithë faktorët që janë të angazhuar në Maturën Shtetërore.

- Ka bashkëpunuar me Junior Achievement Albania, për zbatimin e edukimit ekonomik, pjesë e kurrikulës bërthamë në arsimin parauniversitar.
- Ka bashkëpunuar me Avokatin e Popullit për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit tek nxënësit mbi të drejtat themelore të fëmijëve.
- Ka bashkëpunuar me World Vision mbi edukimin dhe barazinë gjinore.
- Ka bashkëpunuar me Qendrën Evropiane mbi përmirësimin e njohurive dhe rritja e kapaciteteve të të rinjve dhe mësuesve, psikologëve dhe punonjësve social të shkollave, për luftën kundër diskriminimit, me një fokus të veçantë tek gjuha e urrejtjes dhe bullizmi ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë.
- Ka bashkëpunuar me Shoqatën “Barleti” për edukimin e të rinjve mbi vlerat dhe qëndrimet europiane.
- Ka bashkëpunuar me Komitetin e Helsinkit duke organizuar aktivitete mbi edukimin qytetar dhe edukimin ligjor.
- Ka bashkëpunuar me Institutin për Demokraci dhe Integrim për koordinimin e aktiviteteve mbi Mbështetjen rehabilituese dhe riintegruese për personat që kthehen nga zonat e konflikt.
- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, (draft për të ndryshuar).
- Draft strategjinë 2021-2026 MASR.
- Udhëzimin Nr.12, datë 22.05.2019 “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimi e portalit.
- Draft rregulloren e PKAB.
- Udhëzim për vitin shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar.
- Udhëzim për shkollat profesionale.
- Etj.

XI. KËSHILLIME

Gjatë veprimtarive monitoruese/vlerësuese në institucionet arsimorë, grupet vlerësuese, bazuar në gjetjet dhe gjykimet gjatë vitit 2021, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor që ato ofrojnë, kanë këshilluar institucionet arsimore parauniversitare si më poshtë:

- Drejtoritë e shkollave të hartojnë plane afatmesëm me synim të qartë dhe objektivat të jenë me qëllim realizimin e synimit, të respektojnë rubrikat sipas përcaktimeve të nenit 49, 50 të “Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Drejtoritë e shkollave, në bashkëpunim me grupet e punës, të hartojnë plane vjetore mbi objektiva të matshëm dhe të krahasueshme, si dhe këto objektiva të jenë në funksion të synimit të shkollës.
- Drejtoritë e shkollave, në bashkëpunim me grupet e punës, të hartojnë plane vjetore të mbështetur në analizën e vitit të mëparshëm, si dhe të jenë vazhdimësi e planit afatmesëm.
- Drejtoritë e shkollave të hartojnë rregulloren e brendshme me të gjitha rubrikat e përcaktuara në udhëzimin nr.30, datë 02.08.2013 “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.

- Stafi drejtues të hartojë dhe realizojë planin e vjetor/mujor/javor të vlerësimit të procesit mësimor.
- Drejtoritë e shkollave të përdorin instrumente vlerësimi vjetore për mësuesit bazuar në “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AF, AMU e AML”, analizat e vlerësimit të arritjeve dhe kriteret zyrtare.
- Drejtoritë e shkollave për vlerësimin e arritjeve të përdorin instrumente vlerësimi duke ju referuar vlerësimit të brendshëm të shkollës.

XII. KUALIFIKIM I BRENDSHËM, TRAJNIME

Një nga drejtimet e rëndësishme të DPAP-së është edhe zhvillimi profesional në vijueshmëri i specialistëve të saj. Gjatë vitit 2021 janë realizuar veprimtari profesionale dhe trajnime si:

- Shkrimi i raporteve të vlerësimeve/inspektimeve për institucionet, shkollat dhe kopshtet e inspektuara.
- Përgatitja e informacioneve të monitorimeve të kryera.
- Përgatitja e raportit vjetor dhe 6-mujor për veprimtarinë e DPAP-së.
- Trajnim i brendshëm për vlerësimin e IAP-ve për vlerësimin e orës mësimore.
- Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit për platformat e monitorimit dhe vlerësimit të IAP-ve apo Zyrave vendore të Arsimit Parauniversitar, etj.

Tiranë, Janar 2022

